



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR¹

DRAFT LAW ON PROTECTION OF CLASSIFIED INFORMATION²

NACRT ZAKONA O ZAŠTITI KLASIFIKOVANIH INFORMACIJA³

¹ Projektligji per mbrojtjen e informacionit te klasifikuar eshte aprovuar ne mbledhjen e 96 te Qeverise se Kosoves, me Vendimin Nr. 02/96, date 14.09.2022

² Draft Law on protection of classified information was approved on the 96 meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 02/96, date 14.09.2022

³ Nacrt Zakona o zastiti klasifikovanih informacija usvojen je na 96 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.02/96, datum 14.09.2022

| | | |
|---|--|--|
| <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">LIGJ PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Qëllimi i këtij ligji është themelimi parimeve bazë, standardeve minimale të sigurisë si dhe një sistemi unik për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Me këtë ligj themelohet Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (në tekstin e mëtejshëm: AMIK) ku përcaktohet misioni, organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e saj.</p> <p>3. Ky ligj është në harmoni me legjislacionin e BE-së, si në vijim:</p> | <p>The Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p style="text-align: center;">LAW ON PROTECTION OF CLASSIFIED INFORMATION</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>1. The purpose of this Law is the establishment of basic principles, minimum security standards and the unique system for protection of classified information related to the security interests of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. This Law establishes the Agency for Protection of Classified Information (hereinafter referred to as APCI), whereby determining its mission, structure, functioning, duties and responsibilities.</p> <p>3. This Law is in line with the EU legislation, as follows:</p> | <p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O ZAŠTITI KLASIFIKOVANIH INFORMACIJA</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>1. Cilj ovog zakona je uspostavljanje osnovnih principa minimalnih standarda bezbednosti kao i jedinstvenog sistema za zaštitu klasifikovanih informacija koje se odnose na interese bezbednosti Republike Kosovo.</p> <p>2. Ovim zakonom se osniva Agencija za zaštitu klasifikovanih informacija (u daljem tekstu: AZKI) gde se utvrđuje njena misija, organizacija, funkcionisanje, dužnosti i odgovornosti</p> <p>3. Ovaj zakon je u saglasnosti sa EU leglaciju, kao sto sledi:</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>3.1. Vendimin e Këshillit të 23 shtatorit 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet publike që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore, për personat fizik dhe juridik, që bazuar në parimin e nevojës për të ditur, në ushtrimin e detyrës mund të kenë qasje në informacionin e klasifikuar të Republikës së Kosovës, shteteve dhe organizatave tjera ndërkombëtare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Mbrojtja e informacionit të klasifikuar</p> <p>1. Informacioni i klasifikuar mbrohet në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Çdo person të cilit i është besuar informacioni i klasifikuar ose është njohur me përmbajtjen e tij, është përgjegjës për mbrojtjen e tij në përputhje me këtë ligj.</p> <p>3. Tërësia e informacionit të klasifikuar mbrohet sipas nivelit më të lartë të klasifikimit që e posedon përbërësi i tij.</p> | <p>3.1. Council decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>This Law applies to all public institutions exercising executive, legislative and judicial competencies and natural and legal persons, which based on the need-to-know principle could, while discharging their duties, have access to classified information of the Republic of Kosovo, other states and international organizations.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Protection of classified information</p> <p>1. Classified information is protected in accordance with this law.</p> <p>2. Any person entrusted with classified information or is familiar with its content is responsible for its protection in accordance with this law.</p> <p>3. The entirety of classified information is protected by the highest classification level that its component possesses.</p> | <p>3.1. Odluka Vijeća od 23. rujna 2013 o sigurnosnim propisima za zaštitu lasificiranih podataka EU-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Ovaj zakon se odnosi na sve javne institucije koje obavljaju izvršne, zakonodavne i sudske nadležnosti, na fizička i pravna lica, koja na osnovu principa “nužnost pristupa informacijama”, u vršenju dužnosti mogu imati pristup klasifikovanim informacijama Republike Kosovo, država i drugih međunarodnih organizacija.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Zaštita klasifikovanih informacija</p> <p>1. Klasifikovani podaci su zaštićeni u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2. Svako lice kome je poverena poverljiva informacija ili je upoznat sa njenim sadržajem odgovoran je za njegovu zaštitu u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>3. Celokupnost klasifikovanih informacija zaštićena je najvišim nivoom klasifikacije koju poseduje njegova komponenta.</p> |
|---|---|--|

| <p style="text-align: center;">Neni 4 Përkufizimet</p> | <p style="text-align: center;">Article 4 Definitions</p> | <p style="text-align: center;">Član 4 Definicije</p> |
|---|---|--|
| <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Informacion i klasifikuar - çdo informacion ose material për të cilin është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi, zbulimi i paautorizuar i të cilit do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. Nevojë për të ditur - është nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, në kuadrin e një funksioni të caktuar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike;</p> <p>1.3. Klasifikim - akti apo procesi përmes të cilit një informacioni i përcaktohet niveli i klasifikimit;</p> <p>1.4. Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (në tekstin e mëtejshëm: AMIK) - nënkupton Autoritetin e Sigurisë Kombëtare përgjegjëse për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. Autoritet verifikues, është Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar e specializuar për kryerjen e verifikimeve të sigurisë ndaj personave që</p> | <p>1. Terms used in this Law shall have the following meanings:</p> <p>1.1. Classified information any information or material for which a certain classification level has been set, whose unauthorized disclosure would affect to various degrees the security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. Need-to-know – the need of access to classified information in the light of a certain position and for the purpose of fulfilling a specific duty;</p> <p>1.3. Classification – the act or process of determining the level of classification and the time period for maintaining such classification;</p> <p>1.4. Agency – Agency for Protection of Classified Information (APCI); means the National Security Authority responsible for the protection of Classified Information in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Verification authority - the Agency for Protection of Classified Information, as a structural unit specialized for conducting security clearances for</p> | <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Klasifikovana informacija, je svaka informacija ili materijal, za koju je postavljen određen nivo klasifikacije čije bi neovlašćeno otkrivanje ugrozilo u različitim stepenima bezbednosne interese Republike Kosovo;</p> <p>1.2. Potreba da se zna - je potreba da se ima pristup tajnim podacima, u kontekstu određene funkcije i kako bi se ispunio određeni zadatak;</p> <p>1.3. Klasifikacija - akt ili proces putem kojeg se informaciji određuje stepen klasifikacije i rok čuvanja ove klasifikacije;</p> <p>1.4. Agencija zaštitu klasifikovanih informacija (AZKI) podrazumeva Nacionalni bezbednosni organ odgovoran za zaštitu poverljivih podataka u Republici Kosovo"</p> <p>1.5. Organ za proveru, je Agencija za zaštitu klasifikovanih informacija, specijalizovana za vršenje bezbednosnih provera lica koja će saznati, proizvoditi, čuvati, upravljati,</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>njohin prodhojnë, ruajnë administrojnë, transportojnë dhe transmetojnë informacion të klasifikuar;</p> <p>1.6. Pyetësori i sigurisë, është formulari që plotëson çdo person që kërkon të njihet me informacion të klasifikuar dhe mbi bazën e të cilit kryhet verifikimi i sigurisë si dhe vlerësohen të dhënat për të lëshuar ose jo “Certifikatën e Sigurisë të Personelit”;</p> <p>1.7. Certifikata e Sigurisë së Personelit (në tekstin e mëtejme: CSP), është dokumenti zyrtar i AMIK-ut ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një person i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar e vlefshme për një kohë të caktuar dhe nivel të caktuar të qasjes;</p> <p>1.8. Shkelje sigurie, është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit në fuqi që rezulton ose mund të rezultojë në vjedhjen, humbjen, dëmtimin, komprometimin apo zbulimin e paautorizuar të informacionit të klasifikuar;</p> | <p>individuals who will obtain knowledge, produce, store, administer, transport and transmit classified information;</p> <p>1.6. Security Clearance Questionnaire - the form completed by any individual requiring access to classified information, and serves as the base for security clearance and assessment of data for the issuance or rejection of “Personnel Security Clearance” certificate;</p> <p>1.7. Personnel Security Clearance (PSC) - the official document of APCI, or competent security authority of another country, which confirms, in terms of security, that a person meets the conditions set for obtaining knowledge, storing, administering and transferring classified information valid for a certain time and a certain level of access;</p> <p>1.8. Security breach - an act or omission in contradiction with the applicable legislation that results, or may result in theft, loss, damage, compromise or unauthorized disclosure of classified information;</p> | <p>transportovati i prenositi klasifikovane informacije;</p> <p>1.6. Bezbednosni upitnik, je obrazac koji popunjava svako lice za koje se zahteva da se upozna sa klasifikovanim informacijama i na osnovu kojeg se vrši bezbednosna provera i ocenjuju podaci za izdavanje ili neizdavanje "Bezbednosne dozvole za osoblje";</p> <p>1.7. Bezbednosna dozvola za osoblje (BDO), je službeni dokument AZKI-a ili nadležnog organa bezbednosti druge zemlje, koji potvrđuje sa stanovišta bezbednosti da neko lice ispunjava uslove utvrđene za saznanje, čuvanje, upravljanje i prenos klasifikovanih informacija za koje važi određeno vreme i određeni nivo pristupa;</p> <p>1.8. Povreda bezbednosti, je radnja ili propust u suprotnosti sa važećim zakonodavstvom koje dovodi ili može dovesti do krađe, gubitka, oštećenja, kompromitovanja ili neovlašćenog otkrivanja klasifikovanih informacija;</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.9. Verifikimi i sigurisë, është tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një personi fizik apo juridik, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së Sigurisë të Personelit”;</p> <p>1.10 Rrezik i papranueshëm sigurie, konsiderohen rrethanat e përshkruara në këtë Ligj, në bazë të të cilave AMIK-u refuzon dhënien e CSP-së ose vlerëson se duhet të ndërmarrë masën e heqjes ose të pezullimit të përkohshëm të saj;</p> <p>1.11. Rrethana të urgjencës, konsiderohen kushtet e pamundësisë objektive për të ndjekur procedurat normale të pajisjes me CSP, për shkak të ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare të pjesëmarrjes në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, zgjatjes së afateve të misioneve ushtarake në vende të ndryshme etj;</p> <p>1.12. Zyrtar sigurie, është punonjësi përgjegjës ose struktura e ngarkuar nga titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurimin e personelit dhe disiplinat e tjera të informacionit të klasifikuar;</p> | <p>1.9. Security Clearance - the set of measures and procedures applied to a natural or legal person, and which serve as the basis for issuance, rejection, temporary suspension or withdrawal of “Personnel Security Clearance” certificate;</p> <p>1.10. Unacceptable Security Risk - circumstances described in this Law, based on which APCI refuses the granting of PSC, or considers that the measure of its withdrawal or temporary suspension should be taken;</p> <p>1.11. Circumstances of Exceptional Urgency – conditions of objective inability to follow normal procedures for issuing a PSC due to the exercise of a short-term official duty of participation in an unpredicted international activity, extending military missions in various countries, etc.</p> <p>1.12. Security Officer (hereinafter SO) - the employee responsible for, or the structure charged by the head of the ministry, or state institution, for supervising and implementing requests for personnel security, and other disciplines of classified information;</p> | <p>1.9. Bezbednosna provera, predstavlja skup mera i procedura koje se primenjuju prema fizičkom ili pravnom licu, na osnovu kojih će biti procenjeno izdavanje, odbijanje, privremeno obustavljanje ili ukidanje "Bezbednosne dozvole za osoblje";</p> <p>1.10. Neprihvatljiv bezbednosni rizik, smatraju se okolnosti opisane u ovom zakonu, na osnovu kojih AZKI odbija izdavanje BDO ili procenjuje da mora preduzeti meru njenog privremenog ukidanja ili obustavljanja;</p> <p>1.11. Okolnosti vanredne situacije, se smatraju uslovi objektivne nemogućnosti za praćenje normalnih procedura za dobijanje BDO, zbog vršenja kratkoročne službene dužnosti za učešće u nepredviđenim međunarodnim aktivnostima, produženje rokova vojnih misija u različitim zemljama itd.</p> <p>1.12. Službenik za bezbednost, je odgovorno zaposleno lice ili struktura koja je postavljen od strane rukovodioca ministarstva ili državne institucije za nadzor i sprovođenje zahteva za bezbednost osoblja i drugih disciplina klasifikovanih informacija;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.13. Kontratë e klasifikuar - çdo kontratë e lidhur nga një institucion publik me një kontraktues për furnizimin e mallrave, ekzekutimin e punëve ose ofrimin e shërbimeve, kryerja e të cilave kërkon apo përfshin qasjen ose krijimin e informacionit apo materialit të klasifikuar të klasifikuar sipas këtij ligji;</p> <p>1.14. Nënkontratë e klasifikuar - çdo kontratë e nënshkruar nga një kontraktues i një institucioni publik me një tjetër kontraktues (dmth. Nënkontraktuesin) për furnizimin e mallrave, ekzekutimin e punëve ose ofrimin e shërbimeve, kryerja e të cilave kërkon ose përfshin hyrjen ose krijimin e informacion; të klasifikuar;</p> <p>1.15. Deklasifikim - heqja e çfarëdo niveli të klasifikimit;</p> <p>1.16 Dokument – çdo informacion i regjistruar pavarësisht nga forma fizike ose karakteristikat ” e tij;</p> <p>1.17 Degradim - vendimin që informacioni i klasifikuar dhe i ruajtur në një nivel të përcaktuar klasifikohet dhe ruhet në nivel më të ulët klasifikimi;</p> <p>1.18. Material - çdo dokument, bartës i të dhënave, pjesë e makinerive, pajisje të prodhuara ose në procesin e prodhimit;</p> | <p>1.13. Classified Contract – any contract concluded by a public institution with a contractor for the supply of goods, execution of works or provision of services, the performance of which requires or involves the access or creation of classified information or material classified under this Law;</p> <p>1.14. Classified Subcontract - any contract signed by a contractor of a public institution with another contractor (ie subcontractor) for the supply of goods, execution of works or provision of services, the performance of which requires or involves the entry or creation of information ; classified</p> <p>1.15. Declassification - removal of any classification level;</p> <p>1.16. Document - any information recorded regardless of its physical form or characteristics;</p> <p>1.17. Downgrading – a decision that information classified and safeguarded at a set level is classified and safeguarded at a lower level of classification.</p> <p>1.18. Material - any document, data carrier, parts of machinery, equipment produced or in the production process;</p> | <p>1.13. Klasifikovani ugovor - svaki ugovor zaključen od strane javne institucije sa ugovaračem za isporuku robe, izvršenje radova ili pružanje usluga, čije izvršavanje zahteva ili uključuje pristup ili stvaranje klasifikovanih informacija ili materijala klasifikovanih prema ovom Zakonu ;</p> <p>1.14. Klasifikovani podugovor - svaki ugovor potpisan od strane ugovarača javne ustanove sa drugim ugovaračem radova (tj. Podugovaračem) za snabdevanje robe, izvršenje radova ili pružanje usluga, čije obavljanje zahteva ili uključuje unošenje ili stvaranje klasifikovanih informacija;</p> <p>1.15. Deklasifikacija - uklanjanje bilo kojeg nivoa klasifikacije;</p> <p>1.16. Dokument - bilo koja informacija koja se evidentira bez obzira na njen fizički oblik ili karakteristike;</p> <p>1.17. Degradacija - odluka da se klasifikovane i sačuvane informacije na određenom stepenu klasifikuju i čuvaju na nižem stepenu klasifikacije.</p> <p>1.18. Materijal – bilo koji dokument, nosač podataka, deo mašina, opreme koji su proizvedeni ili u procesu proizvodnje.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.19. Mbajtësi i autorizuar i informacioneve të klasifikuara – personi fizik ose personi juridik i cili ka në posedim informacionin e klasifikuar, ka CSP të vlefshme të sigurisë dhe i plotëson kushtet tjera që lejojnë qasjen në informacionin e klasifikuar, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj;</p> <p>1.20 “Certifikata e Sigurisë Industriale” (në tekstin e mëtejshëm: CSI) është dokumenti zyrtar i AMIK-ut, ose i një Autoriteti Kompetent të Sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike, fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, në një projekt/program, apo kontratë/nëkontratë të klasifikuar.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLIII SIGURIMI I INFORMACIONIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Autoriteti Klasifikues</p> <p>1. Autoriteti për klasifikimin e informacionit ushtrohet nga:</p> | <p>1.19. Authorized holder of classified Information a natural person or a legal person possessing classified information has valid security CSPs and meets other conditions that allow access to Classified Information, unless otherwise provided by law;</p> <p>1.20 “Industrial Security Clearance” certificate (hereinafter ISC), is an official document of APCI, or competent security authority of another country, whereby confirming, in terms of security, that an economic operator has organizational, technical, physical capacities and abilities and fulfils standards set for access, storage and administration of classified information in a project/program, or classified contract/sub-contract.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II INFORMATION SECURITY</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Classification Authority</p> <p>1. The authority of classifying information shall be exercised by:</p> | <p>1.19. Ovlaščeni nosilac klasifikovanih podataka - fizičko ili pravno lice koje poseduje poverljive informacije ima važeći BDI bezbednosti i ispunjava druge uslove koji omogućavaju pristup klasifikovanim podacima, ako zakonom nije drugačije određeno;</p> <p>1.20. Sertifikat o industrijskoj bezbednosti", dalje je CIB je zvanični dokument AZKI-a ili nadležnog bezbednosnog organa druge zemlje, koji potvrđuje sa bezbednosne tačke gledišta da neki ekonomski operater ima organizacione, tehničke, fizičke organizativne kapacitete i sposobnosti i zadovoljava standarde utvrđene za priznavanje, čuvanje i administriranje klasifikovanih informacija u nekom projektu / programu ili klasifikovanom ugovoru / podugovoru.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II BEZBEDNOST INFORMACIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Autoritet za klasifikaciju</p> <p>1. Autoritet za klasifikaciju informacija vrši:</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>1.1. Presidenti; 1.2. Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit;</p> <p>1.3. Kryeministri dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë; 1.4. Kryetari i Gjykatës Supreme; 1.5. Kryeprokurori i Shtetit; 1.6. Drejtori i AKI-së; 1.7. Komandanti i FSK-së; 1.8. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë; 1.9. Udhëheqësit e Institucioneve të Pavarura.</p> <p>2. Autoritetet për klasifikimin e informacionit të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, kanë të drejtë të delegojnë kompetencën e klasifikimit tek drejtuesit e institucioneve në vartësi të tyre, pasi drejtuesit të jenë informuar për rregullat dhe procedurat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe që kanë pranuar individualisht përgjegjësitë e saj në lidhje me mbrojtjen e informacionit të tillë.</p> <p>3. Kërkesa për dhënien e autorizimit nga Autoriteti klasifikues i dërgohet AMIK-ut, e cila pas shqyrtimit dhe vlerësimit, rekomandon për dhënien ose jo të autorizimit.</p> <p>4. Autorizimi i kompetencës për klasifikim bëhet me shkrim dhe e identifikon qartë titullarin me emër dhe titull të pozitës dhe ky autorizim vlen vetëm për kohën sa është titullar i institucionit përkatës.</p> | <p>1.1. President; 1.2. The President of the Assembly and the members of the Presidency of the Assembly; 1.3. Prime Minister and other members of the Government; 1.4. President of the Supreme Court; 1.5. Chief State Prosecutor; 1.6. Director of KIA; 1.7. Commander of KSF; 1.8. Police General Director; 1.9. The Leaders of Independent Institutions.</p> <p>2. Authorities responsible for information classification provided for in paragraph 1 of this article shall be entitled to transfer the classification competence to the heads of their subordinate institutions, as executives are informed of the rules and procedures for the security of classified information protection and have individually admitted their responsibilities with regard to the protection of such information.</p> <p>3. The request for granting authorization by the Classification Authority shall be submitted to APCI, which after reviewing and assessing, recommends for granting authorization or not.</p> <p>4. Any authorization of the competency to classify information shall be done in writing and clearly identify the title holder by name and the title of the position. This authorization shall be valid only for</p> | <p>1.1 Predsednik; 1.2 Predsednik Skupštine i članovi predsedništva Skupštine; 1.3 Premijer i ostali članovi Vlade; 1.4 Predsednik Vrhovnog suda; 1.5 Glavni državni tužilac; 1.6 Direktor OAK-a; 1.7 Komandant KSB-a; 1.8 Generalni direktor Policije; 1.9 Rukovodioci nezavisnih ustanova.</p> <p>2. Autoriteti za klasifikaciju informacija propisani u stavu 1. ovog člana, imaju pravo da prenose nadležnost klasifikacije rukovodiocima institucija pod njihovim nadzorom, nakon što rukovodioci budu informisani o pravilima i procedurama za bezbednost za zaštitu poverljivih podataka i koji su pojedinačno prihvatili svoje odgovornosti u pogledu zaštite takvih informacija.</p> <p>3. Zahtev za davanje ovlašćenja od strane Autoriteta za klasifikaciju dostavlja se AZKI, koja nakon razmatranja i procenjivanja, preporučuje davanje ili nedavanje ovlašćenja.</p> <p>4. Svako ovlašćenje nadležnosti za klasifikaciju vrši se pismeno i jasno identifikuje rukovodioca po imenu i nazivu položaja, a ovo ovlašćenje važi samo za vreme dok je rukovodilac odgovarajuće institucije.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>5. Agjencia harton, mirëmban dhe rregullisht e përditëson regjistrin me të dhënat e personave që kanë kompetencë klasifikimi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Kategoritë e Informacionit që klasifikohen</p> <p>1. Informacioni klasifikohet vetëm nëse është e nevojshme dhe nëse bie brenda një apo më shumë prej këtyre kategorive:</p> <p>1.1. projekte, plane, sisteme apo operacione që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. informacion i shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, marrëdhënie apo veprimtari ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat mbrohen nga ekspozimi i pa autorizuar;</p> <p>1.3. veprimtari, burime informative dhe metodat e punës së organeve dhe institucioneve të inteligjencës që lidhen me sigurinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;</p> | <p>the duration of the position as the head of relevant institution.</p> <p>5. Agency shall draft, maintain and regularly update a register with the names of heads with competence for classification.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Categories of information to be classified</p> <p>1. The information shall be classified only if necessary and if it falls within one or more of these categories:</p> <p>1.1. projects, plans, systems or operations related to the protection and security of the constitutional order of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. information from foreign states and international organizations, relations or activities of the Republic of Kosovo, which will be protected against unauthorized exposure.</p> <p>1.3. activities, information sources and methods of intelligence institutions related to the security of the Republic of Kosovo.</p> <p>1.4. systems, installations, infrastructure, projects, plans or services of protection related to the security interests of the Republic of Kosovo;</p> | <p>5. Agjencia izrađuje, održava i redovno ažurira registar sa imenima rukovodilaca koji imaju nadležnost za klasifikaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Kategorije klasifikovanih informacija</p> <p>1. Informacije se klasifikuju samo ako je potrebno i spadaju u jednu ili više od ovih kategorija:</p> <p>1.1. projekti, planovi, sistemi ili operacije koje se odnose na zaštitu i bezbednost ustavnog poretka Republike Kosovo;</p> <p>1.2. informacije stranih država, i međunarodnih organizacija, međunarodni odnosi ili aktivnosti Republike Kosovo, koje će biti zaštićeni od neovlašćenog izlaganja.</p> <p>1.3. aktivnosti, izvori informacija i metode obaveštajnih institucija vezanih za bezbednost Republike Kosovo.</p> <p>1.4. sistemi, instalacije, infrastruktura, projekti, planovi ili usluge odbrane vezane za bezbednosne interese Republike Kosovo;</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.5. veprimtari shkencore, teknologjike, ekonomike, financiare që lidhen me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6. sisteme kriptologjike, çështjet dhe problemet kriptologjike;</p> <p>1.7. plane operimi dhe përdorimi të sistemit të komunikimit të informacioneve të klasifikuara dhe kriptologjisë;</p> <p>1.8. vlerësimet e rrezikut, raportet e inspektimit lidhur me mangësitë të sistemit të kriptologjisë;</p> <p>1.9. plane për identifikimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e rrezikut që paraqitet në sistemin e komunikimit elektronik;</p> <p>1.10. plane, projekte, programe për sigurimin e sistemeve të komunikimit të informacionit të klasifikuar;</p> <p>1.11. informacionet e mbledhura nëpërmjet operacioneve specifike dhe përgjimeve elektronike që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.</p> | <p>1.5. scientific, technological, economic and financial activities related to the security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6. cryptologic systems; cryptologic issues/problems;</p> <p>1.7. plans on operation and use of the system of communication of classified information and cryptology;</p> <p>1.8. risk assessments/inspection reports related to the shortcomings in cryptology system;</p> <p>1.9. plans for identification, reduction and management of the risk that occurs in the electronic communication system;</p> <p>1.10. plans, projects and programs for securing systems of communication for classified information;</p> <p>1.11. Information collected through specific operations and electronic interceptions, dealing with the protection and security of the Constitutional order of the Republic of Kosovo.</p> | <p>1.5. naučne, tehnološke, ekonomske, finansijske aktivnosti vezane za bezbednosne interese Republike Kosovo;</p> <p>1.6. kriptološki sistemi; kriptološka pitanja/problemi;</p> <p>1.7. operativni planovi i korišćenje sistema klasifikovanih informacija i kriptologije;</p> <p>1.8. procene rizika/izveštaji o inspekciji vezani za nedostatke sistema kriptologije;</p> <p>1.9. planovi za identifikaciju, smanjenje i upravljanje rizikom koji se javlja u sistemu elektronske komunikacije;</p> <p>1.10. planovi, projekti, programi za obezbeđivanje komunikacionih sistema klasifikovanih informacija;</p> <p>1.11. informacije prikupljene putem specifičnih operacija i elektronskog presretanja koje se odnose na zaštitu Ustavne bezbednosti i reda Republike Kosovo.</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 7 Ndalimi i klasifikimit të informacionit</p> <p>1. Ndalohet klasifikimi i informacionit kur ai bëhet me qëllim që:</p> <p>1.1. të fshehë shkeljet e ligjit, keqpërdorimin e autoritetit, mos efikasitetin apo gabimin administrativ;</p> <p>1.2. t'i privojë të drejtën e njohjes një personi, organizate apo institucioni;</p> <p>1.3. të pengojë apo të vonojë dhënien e informacionit qe nuk kërkon mbrojtje në interes të sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4. që kufizojnë konkurrencën.</p> | <p style="text-align: center;">Article 7 Prohibition of information classification</p> <p>1. The classification of information is prohibited when done for the purpose of:</p> <p>1.1. hiding law violation, abuse of authority, lack of efficiency or administrative error,</p> <p>1.2. depriving the right to recognize a person, organization or institution,</p> <p>1.3. hampering or delaying the provision of information that is not required to be protected in the interest of security of the Republic of Kosovo, and</p> <p>1.4. that limit competition.</p> | <p style="text-align: center;">Član 7 Zabrana klasifikacije informacija</p> <p>1. Klasifikacija informacija je zabranjena kada se to radi sa ciljem:</p> <p>1.1. skrivanja kršenje zakona, zloupotrebu ovlašćenja, neefikasnost ili administrativnu grešku;</p> <p>1.2. lišavanja prava saznanja licu, organizaciji ili instituciji;</p> <p>1.3. sprečavanja ili odlaganja pružanja informacija koje ne zahtevaju zaštitu u interesu bezbednosti Republike Kosovo.</p> <p>1.4. koji ograničavaju konkurenciju.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 8 Nivelet e klasifikimit</p> <p>1. Informacioni nisur nga përmbajtja, vlera dhe interesi shtetëror klasifikohet në njërin nga këto nivele:</p> <p>1.1. “TEPËR SEKRET”, zbulimi i paautorizuar i të cilit sipas vlerësimit të arsyeshëm do të shkaktonte dëm jashtëzakonisht të rëndë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> | <p style="text-align: center;">Article 8 Classification levels</p> <p>1. In terms of content, value and state interest, the information shall be classified in one of the following levels:</p> <p>1.1. “TOP SECRET” - unauthorized disclosure of which, under reasonable assessment, could result in exceptionally grave damage to the security interests of the Republic of Kosovo;</p> | <p style="text-align: center;">Član 8 Stepeni klasifikacije</p> <p>1. Informacije na osnovu sadržaja, vrednosti i državnog interesa klasifikuju se na jedan od sledećih stepena:</p> <p>1.1. "STROGA TAJNA", čije neovlašćeno otkrivanje prema razumnoj proceni bi izazvalo izuzetno tešku štetu bezbednosnim interesima Republike Kosovo;</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>1.2. “SEKRET”, zbulimi i paautorizuar i të cilit do t’i dëmtonte seriozisht interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. “KONFIDENCIAL”, zbulimii paautorizuar i të cilit do të mund t’i dëmtonte interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4. “I KUFIZUAR”, zbulimi i paautorizuar i të cilit do të ishte e pafavorshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Autoriteti i Klasifikimit i shmangët klasifikimit të tepërt të informacioneve dhe atyre u cakton vetëm nivel të tillë të klasifikimit që është i nevojshëm për të ruajtur interesat e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Kohëzgjatja e klasifikimit</p> <p>1. Informacioni klasifikohet për aq kohë sa e kërkon interesi i sigurisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Afatet e ruajtjes së klasifikimit janë:</p> <p>2.1. informacioni i klasifikuar: “I KUFIZUAR” një (1) vit;</p> | <p>1.2. “SECRET” – unauthorized disclosure of which would seriously damage security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. “CONFIDENTIAL” – unauthorized disclosure of which would damage security interests of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. “RESTRICTED” – unauthorized disclosure of which would be unfavourable for security interests of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The Classification Authority shall avoid over-classification of information and shall assign to them only a level of classification that is necessary to protect interests of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Duration of classification</p> <p>1. Information shall be classified insofar as it is in the interest of security of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Terms for classification of information shall be as follows:</p> <p>2.1. information classified as “RESTRICTED”, one (1) year;</p> | <p>1.2. "TAJNA", čije neovlašćeno otkrivanje bi ozbiljno ugrozilo bezbednosne interese Republike Kosovo;</p> <p>1.3. "POVERLJIVO", čije neovlašćeno otkrivanje bi mogli ugroziti bezbednosne interese Republike Kosovo;</p> <p>1.4. "OGRANIČENO", čije neovlašćeno otkrivanje bi bilo nepovoljno za bezbednosne interese Republike Kosovo.</p> <p>2. Autoritet za klasifikaciju izbegava prekomernu klasifikaciju informacija i dodeljuje im samo takav stepen klasifikacije koji je potreban da bi se zaštitili interesi Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Trajanje klasifikacije</p> <p>1. Informacije se klasifikuju sve dok to zahteva bezbednosni interes Republike Kosovo.</p> <p>2. Vremenski rokovi čuvanja klasifikacije su:</p> <p>2.1. klasifikovane informacije: "OGRANIČENO" jednu (1) godinu;</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>2.2. informacioni i klasifikuar: “KONFIDENCIAL” pesë (5) vite;</p> <p>2.3. informacioni i klasifikuar: “SEKRET” pesëmbëdhjetë (15) vite; dhe</p> <p>2.4. informacioni i klasifikuar: “TEPËR SEKRET” pesëdhjetë (50) vite.</p> <p>3. Llogaritja e afateve të ruajtjes së klasifikimit fillon nga data e prodhimit të informacionit të klasifikuar.</p> <p>4. Në rast se Autoriteti Klasifikues konsideron se informacioni duhet të mbrohet më gjatë se sa që është paraparë në paragrafin 2 ai nxjerr vendim të ri për klasifikim në pajtim me nenin 8 të këtij ligji. Vendimi i tillë nuk guxon të merret më herët se gjashtë (6) muaj para datës së paraparë për deklasifikim sipas paragrafit 1. të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Kushtet për administrimin e informacionit të klasifikuar</p> <p>1. Prodhimi i informacionit të klasifikuar bëhet vetëm duke u bazuar në listën e informacionit të klasifikuar të aprovuar nga autoriteti klasifikues, në pajtim me procedurën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.</p> | <p>2.2. information classified as “CONFIDENTIAL”, five (5) years;</p> <p>2.3. information classified as “SECRET”, fifteen (15) years; and</p> <p>2.4. Information classified as “TOP SECRET”, fifty (50) years.</p> <p>3. The calculation of the term for classification of information shall start from the date of production of classified information.</p> <p>4. If the Classification Authority considers that information should be protected for a period longer than provided for in paragraph 2, it shall issue a new decision for classification in accordance with Article 8 of this Law. Such a decision shall not be taken earlier than six (6) months before the date foreseen for declassification under paragraph 1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Conditions for administration, usage and circulation of classified information</p> <p>1. Production of classified information shall take place only based on the list of classified information approved by the Classification Authority, in compliance with the procedure determined by the applicable legislation.</p> | <p>2.2. klasifikovane informacije: "POVERLJIVO" pet (5) godina;</p> <p>2.3. klasifikovane informacije: "TAJNA" petnaest (15) godina; i</p> <p>2.4. klasifikovane informacije: "STROGA TAJNA" pedeset (50) godina.</p> <p>3. Izračunavanje vremenskog roka čuvanja klasifikacije počinje od dana proizvodnje klasifikovane informacije.</p> <p>4. Ako Autoritet za klasifikaciju smatra da informacije treba zaštititi duže nego što je propisano u stavu 2, on izdaje novu odluku o klasifikaciji u skladu sa članom 8. ovog zakona. Takva odluka ne sme se doneti ranije od šest (6) meseci pre datuma predviđenog za deklasifikaciju iz stava 1. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Uslovi za upravljanje klasifikovanim informacijama</p> <p>1. Proizvodnja klasifikovanih informacija se vrši samo na osnovu spiska klasifikovanih informacija koje je odobrio Autoritet za klasifikaciju, u skladu sa postupkom utvrđenim važećim zakonodavstvom.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>2. Prodhimi, shfrytëzimi, shumëfishimi, transferimi, transportimi fizik, arkivimi, ruajtja dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar bëhet në përputhje me standardet si në vijim:</p> <p>2.1. Siguria e personelit - përbëhet nga përzgjedhja e personave fizikë, të cilët duhet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar, verifikimin e kushteve për qasjen në informacionin e klasifikuar dhe edukimin e tyre në fushën e sigurisë;</p> <p>2.2. Siguria fizike - është sistemi i masave të dizajnuara për të parandaluar ose penguar qasjen e paautorizuar në informacionin e klasifikuar, ose për të siguruar dëshmi për çdo qasje ose për çdo tentim qasje të paautorizuar;</p> <p>2.3. Siguria e informacionit - sistemi i masave për origjinën, marrjen, regjistrimin, trajtimin, dërgimin, transportimin, bartjen, transportimin me dorë, ruajtjen, heqjen, arkivimin ose ndonjë metodë tjetër të trajtimit të informacionit të klasifikuar, sipas rastit;</p> <p>2.4. Siguria industriale - është zbatimi i masave për të siguruar dhe verifikuar kushtet për qasje nga objekti në informacionin e klasifikuar dhe për të siguruar trajtimin e informacionit të klasifikuar nga objekti në përputhje me këtë ligj;</p> | <p>2. Production, usage, multiplication, transfer, physical transportation, archiving, storage and destruction of classified information shall take place in compliance with the following standards:</p> <p>2.1. Personnel Security - consists of the selection of natural persons who should have access to classified information, the verification of the conditions for access to classified information and their education in the field of security;</p> <p>2.2. Physical Security - is a system of measures designed to prevent or impede unauthorized access to Classified Information, or to provide evidence of any access or any unauthorized access attempt;</p> <p>2.3. Information security - system of measures for the origin, receipt, registration, handling, dispatch, transport, transfer, handover, storage, removal, archiving or any other method of handling classified information, as the case may be;</p> <p>2.4. Industrial Security - is the implementation of measures to ensure and verify the conditions for access to the classified information in the classified information and to ensure the treatment of classified information by the facility in accordance with this Law;</p> | <p>2. Proizvodnja, upotreba, umnožavanje, prenos, fizički transport, arhiviranje, čuvanje i uništenje klasifikovanih informacija vrši se u skladu sa sledećim standardima:</p> <p>2.1. Bezbednost osoblja - sastoji se od izbora fizičkih lica koja treba da imaju pristup tajnim podacima, verifikacija uslova za pristup klasifikovanim informacijama i njihovog obrazovanja u oblasti bezbednosti;</p> <p>2.2. Fizička bezbednost - je sistem mera dizajniran da spreči ili ometa neovlašćeni pristup klasifikovanim informacijama, ili da pruži dokaze o bilo kakvom pristupu ili pokušaju neovlašćenog pristupa;</p> <p>2.3. Informaciona bezbednost - sistem mera za nastanak, prijem, registraciju, rukovanje, otpremu, transport, prenos, predaju, čuvanje, uklanjanje, arhiviranje ili bilo koji drugi način rukovanja tajnim podacima, u zavisnosti od slučaja;</p> <p>2.4. Industrijska bezbednost - je sprovođenje mera za obezbeđenje i proveravanje uslova za pristup tajnim podacima sa objekta, i obezbeđenje tretmana poverljivih informacija od strane objekta u skladu sa ovim zakonom;</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>2.5. Siguria e sistemeve të komunikimit të informacionit – sistemi i masave për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit të klasifikuar të trajtuar nga këto sisteme dhe përgjegjësinë e administratës dhe përdoruesit për zbatimin e tyre në sistemet e informacionit ose komunikimit duke përdorur metoda dhe materiale kriptografike në përpunimin, transmetimin ose ruajtjen e informacionit të klasifikuar;</p> <p>2.6. Drejtuesit e institucioneve publike që prodhojnë dhe administrojnë informacione të klasifikuara obligohen të ndër marrin gjitha veprimet e nevojshme për ndalimin e qasjes së personave të paautorizuar në informacionet e klasifikuara gjatë gjithë ciklit të jetës së informacionit të tillë, prej prodhimit, shumëfishimit, shpërndarjes, transferimit, përpunimit dhe arkivimit të tyre, duke regjistruar në librat përkatës për administrimin e informacioneve të klasifikuara.</p> <p>3. Procedurat për zbatimin e këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga AMIK dhe të miratuar nga Qeveria.</p> | <p>2.5. Security of Information Communication Systems - a system of measures to ensure the confidentiality, integrity and availability of classified information addressed by these systems and the responsibility of the administration and users for their implementation in information or communication systems using cryptographic methods and materials in the processing, transmission or storage of Classified Information;</p> <p>2.6. the Leaders of public institutions that produce and administer classified information are required to undertake all necessary actions to prohibit the unauthorized access of classified information throughout the life cycle of such information from production, multiplication, distribution, transfer, processing and archiving them, registering in the relevant books for the management of classified information.</p> <p>3. Procedures for implementation of this article shall be governed with a bylaw proposed by APCI and adopted by the Government.</p> | <p>2.5. Bezbednost informaciono komunikacionih sistema - sistem mera za obezbeđivanje poverljivosti, integriteta i dostupnosti klasifikovanih informacija koje su obrađene od ovih sistema i odgovornost administracije i korisnika za njihovu implementaciju u informacionim ili komunikacionim sistemima koristeći kriptografske metode i materijale u obradi, prenosu ili skladištenju klasifikovanih informacija;</p> <p>2.6. Rukovodioci javnih ustanova koji proizvode i administriraju klasifikovanim informacijama su dužni da preduzmu sve neophodne radnje za zabranu neovlašćenog pristupa klasifikovanim informacijama tokom životnog ciklusa takvih informacija od proizvodnje, množenja, distribucije, prenosa, obrade i arhiviranja, registracije u odgovarajućim knjigama za upravljanje klasifikovanim informacijama.</p> <p>3. Postupci za sprovođenje ovog člana regulišu se podzakonskim aktom koji predlaže AZKI i odobrava Vlada.</p> |
|---|--|---|

| <p style="text-align: center;">Neni 11 Deklasifikimi</p> | <p style="text-align: center;">Article 11 Declassification</p> | <p style="text-align: center;">Član 11 Deklasifikacija</p> |
|--|---|---|
| <p>1. Informacioni deklasifikohet atëherë kur nuk ka më nevojë për mbrojtje dhe kur zbulimi i tij nuk përbën më rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Autoriteti i Klasifikimit, nga i cili informacioni i klasifikuar e ka origjinën, e bën deklasifikimin e saj.</p> <p>3. Rastet e deklasifikimit të informacionit të klasifikuar janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. kur publikimi i tij diktohet nga interesat shtetërorë më të rëndësishme se nevoja për ta mbajtur të klasifikuar;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. ndodhinë e një ngjarje apo të një date të veçantë siç përcaktohet nga autoriteti i klasifikimit.</p> <p>4. Zbulimi i paautorizuar i informacionit të klasifikuar nuk përbën shkak për deklasifikimin e tij.</p> <p>5. Autoriteti klasifikues i cili ka bërë deklasifikimin e informacionit obligohet t'i njoftojë të gjitha institucionet të cilat e kanë në posedim informacionin e klasifikuar.</p> | <p>1. Information shall be declassified when there is no longer a need for protection and when its publication no longer poses a risk to the security of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The Classification Authority, from which the classified information is originated, shall carry out the declassification.</p> <p>3. Cases of declassification of classified information shall be:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1. when its publication is dictated by state interests that are more important than the need to keep it classified;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. When an event or a particular date occurs as determined by the classification authority.</p> <p>4. Unauthorized disclosure of classified Information shall not constitute a cause for declassification.</p> <p>5. The Classification Authority which has declassified information shall be obliged to notify all institutions that possess the classified information.</p> | <p>1. Informacije se deklasifikuju kada više nema potrebe za zaštitom i kada njihovo objavljivanje više ne predstavlja pretnju za bezbednost Republike Kosovo.</p> <p>2. Autoritet za klasifikaciju, od kojeg klasifikovane informacije potiču, vrši njihovu deklasifikaciju.</p> <p>3. Slučajevi deklasifikacije klasifikovanih informacija su:</p> <p style="padding-left: 20px;">3.1 kada je njihovo objavljivanje diktirano državnim interesima koji su važniji od potrebe da se one klasifikuju;</p> <p style="padding-left: 20px;">3.2. pojava događaja ili određenog datuma kako je utvrđeno od strane Autoriteta za klasifikaciju.</p> <p>4. Neovlašćeno otkrivanje klasifikovanih informacija ne predstavlja razlog za njihovu deklasifikaciju.</p> <p>5. Autoritet za klasifikaciju koji je izvršio deklasifikaciju informacija dužan je da obavesti sve institucije koje poseduju klasifikovane informacije;</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>6. Procedurat për zbatimin e këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga AMIK dhe të miratuar nga Qeveria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Asgjësimi dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar</p> <p>1. Në çdo institucion shtetëror titullari i institucionit apo i autorizuari i tij krijon komisionet për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar.</p> <p>2. Komisioni për asgjësim shqyrton dhe vendos për asgjësimin e informacionit të klasifikuar kur ky informacion nuk ka vlerë për ruajtje të mëtejshme, dhe nuk duhet të deklasifikohet.</p> <p>3. Komisioni për shkatërrim duke u bazuar në vendimin e Komisionit për asgjësim, kryen të gjitha procedurat për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar, dhe përgatit raportin përfundimtar.</p> <p>4. Informacioni i cili duhet të dorëzohet në rrjetin arkivor nuk duhet të asgjësohet dhe shkatërrohet, por deklasifikohet.</p> <p>5. Procedurat për zbatimin e këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga AMIK dhe të miratuar nga Qeveria.</p> | <p>6. The procedures for the implementation of this Article shall be regulated by a sub-legal act, proposed by APCI and approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Disposal and Destruction of Classified Information</p> <p>1. In any state institution, the head of the institution or its authorized representative shall establish the commissions for disposal and destruction of classified information.</p> <p>2. The commission for disposal shall review and decide on the disposal of classified information, in cases when this information is of no value for further retention and shall not be declassified.</p> <p>3. Commission for destruction, based on the Decision of the Commission for Disposal, shall carry out all procedures regarding the destruction of classified information and prepare the final report.</p> <p>4. Information that shall be submitted to the archive network should not be disposed and destroyed but declassified.</p> <p>5. Procedures for implementation of this Article shall be regulated by a sub-legal act proposed by APCI and approved by the Government.</p> | <p>6. Procedure za sprovođenje ovog člana regulišu se podzakonskim aktom koji predlaže AZKI i odobrava Vlada.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Uništavanje klasifikovanih informacija</p> <p>1. U svakoj državnoj instituciji rukovodilac institucije ili njegov ovlašćeni predstavnik uspostavlja komisije za uništavanje klasifikovanih informacija.</p> <p>2. Komisija za uništavanje razmatra i odlučuje o uništavanju klasifikovanih informacija kada ove informacije nemaju vrednost za dalje čuvanje i ne moraju biti deklasifikovane.</p> <p>3. Komisija za uništavanje na osnovu svojih odluka, vrši sve postupke za uništavanje klasifikovanih informacija i priprema završni izveštaj.</p> <p>4. Informacije koje se moraju dostaviti arhivskoj mreži ne smeju se uništavati, već se deklasifikuju.</p> <p>5. Procedure za sprovođenje ovog člana regulišu se podzakonskim aktom koji predlaže AZKI i odobrava Vlada.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 13 Degradimi dhe ngritja e nivelit të klasifikimit</p> <p>1. Autoriteti i klasifikimit, nga i cili e ka origjinën informacioni i klasifikuar, është përgjegjës për degradimin ose ngritjen e nivelit të klasifikimit të një informacioni të tillë.</p> <p>2. Autoriteti kompetent i klasifikimit e degradon ose ngrit nivelin e klasifikimit nëse njoftohet për fakte që tregojnë qartë që informacioni i klasifikuar nuk kërkon nivelin e mbrojtjes i cili akordohet në nivelin ekzistues të klasifikimit.</p> <p>3. Procedurat e klasifikimit të informacioneve, duke përfshirë klasifikimin e pjesëve të dokumenteve, dokumenteve të ndara dhe shenjëzimet që mbajnë informacionet e klasifikuar, deklasifikimin dhe rishikimin e nivelit të klasifikimit përcaktohen me akt nënligjor që propozohet nga AMIK dhe miratohet nga Qeveria.</p> | <p style="text-align: center;">Article 13 Downgrading and Upgrading of Classification Level</p> <p>1. The Classification Authority, which has originated classified information, shall be responsible for the downgrading of the classification level of such information.</p> <p>2. The competent classification authority shall downgrade or upgrade the classification level if it becomes aware of facts that clearly indicate that the classified information does not require the level of protection associated with the existing level of classification.</p> <p>3. Information classification procedures, including the classification of parts of documents, separate documents and markings that keep classified information, declassification and revision of the classification level are defined by sub-legal act proposed by AMIK and approved by the Government.</p> | <p style="text-align: center;">Član 13 Degradiranje i povećanje stepena klasifikacije</p> <p>1. Autoritet za klasifikaciju, od kojeg potiču klasifikovane informacije, odgovoran je za degradiranje ili povećanje stepena klasifikacije takvih informacija.</p> <p>2. Nadležni Autoritet za klasifikaciju degradira ili podiže stepen klasifikacije ako je upoznat sa činjenicama koje jasno ukazuju da klasifikovane informacije ne zahtevaju stepen zaštite koji se dodeljuje prema postojećem stepenu klasifikacije.</p> <p>3. Procedure klasifikacije informacija, uključujući klasifikaciju delova dokumenata, posebnih dokumenata i oznaka koje nose klasifikovane informacije, deklasifikaciju i reviziju nivoa klasifikacije, utvrđuju se podzakonskim aktom koji predlaže AZIK i odobrava Vlada.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 14 Propozimi i shtetasve</p> <p>1. Kur një shtetas apo nëpunës i Republikës së Kosovës, që nuk ka autoritet klasifikimi, vlerëson se një informacion i caktuar nën kontrollin e shtetit, ka vlerat e nevojshme për t'u klasifikuar, i propozon institucionit përkatës klasifikimin e këtij informacioni. Ky institucion vendos brenda</p> | <p style="text-align: center;">Article 14 Citizens Proposals</p> <p>1. When a citizen or employee of the Republic of Kosovo, who has no classification authority, considers that particular information under the state's control has the necessary values to be classified, he or she shall propose the classification of this information to the relevant institution. This</p> | <p style="text-align: center;">Član 14 Predlog građana</p> <p>1. Kada građanin ili službenik Republike Kosovo, koji nema ovlašćenje za klasifikaciju, procenjuje da određene informacije pod kontrolom države imaju potrebne vrednosti da budu klasifikovane, predlaže odgovarajućoj instituciji klasifikaciju ovih informacija. Ova</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>dhjetë (10) ditëve, nëse informacioni do të klasifikohet ose jo dhe njofton shtetasin apo nëpunësin për vendimin e marrë.</p> <p>2. Nga momenti i propozimit për klasifikimin e informacionit përkatës, poseduesi i tij obligohet ta mbrojë informacionin nga qasja e paautorizuar.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III SIGURIA E PERSONELIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Siguria e personelit</p> <p>1. Siguria e personelit, është tërësia e masave dhe e procedurave mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një person, duke ju përmbajtur besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të patur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Certifikata e Sigurisë së Personelit</p> <p>1. Autoritetit Verifikues ia lëshon CSP vetëm atij personi i cili pas kryerjes të një procedure të verifikimit të sigurisë në pajtim me legjislacionin në fuqi është përcaktuar si rrezik i pranueshëm për sigurinë.</p> | <p>institution shall decide within 10 days whether the information will be classified or not and shall notify the citizen or the employee of the decision taken.</p> <p>2. From the moment of the proposal on the classification of relevant information, its possessor shall be obliged to protect the information from unauthorized access.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III PERSONNEL SECURITY</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Personnel Security</p> <p>1. Personnel security shall mean the set of measures and procedures based on which is assessed on whether a person, while maintaining his loyalty, reliability and security, can be authorized to access classified information without jeopardizing the security of said information.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Personnel Security Clearance</p> <p>1. The Verifying Authority shall issue the PSC only to the person who, after carrying out a security clearance procedure in accordance with the applicable law, is designated as an acceptable security risk.</p> | <p>institucija odlučuje u roku od 10 dana da li će se informacije klasifikovati ili ne i obaveštava građanina ili službenika o donetoj odluci.</p> <p>2. Od trenutka predloga za klasifikaciju odgovarajućih informacija, njihov posednik je obavezan da štiti informacije od neovlašćenog pristupa</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III BEZBEDNOSNA PROVERA OSOBLJA</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Bezbednosna provera osoblja</p> <p>1. Bezbednosna provera osoblja je skup mera i postupaka na osnovu kojih se procenjuje da li lice, pridržavajući se lojalnosti, pouzdanosti i bezbednosti, može biti ovlašćeno za pristup klasifikovanim informacijama, bez ugrožavanja bezbednosti ovih informacija.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Bezbednosna dozvola za osoblje</p> <p>1. Autoritet za verifikaciju izdaje BDO samo licu koje je, nakon obavljanja postupka bezbednosne provere u skladu sa važećim zakonodavstvom, utvrđeno kao prihvatljivi rizik za bezbednost.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>2. CSP tregon qartë nivelin e informacionit të klasifikuar, në të cilën personi që e ka kaluar procedurën e verifikimit të sigurisë mund të ketë qasje. CSP për një nivel të caktuar të klasifikimit i jep bartësit qasje edhe në informacionet me nivel më të ulët të klasifikimit.</p> <p>3. Çdo titullar i institucionit publik obligohet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të zbatojë vendimin e Autoritetit Verifikues dhe nuk jep qasje në informacione të klasifikuar një personi të cilit i është refuzuar CSP.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar</p> <p>1. Të drejtë për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar e kanë vetëm personat, që:</p> <p>1.1. sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i institucionit ose Zyrtari i Sigurisë Industriale të Kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë;</p> <p>1.2. janë të informuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë dhe të ketë nënshkruar deklaratën e ruajtjes së informacionit;</p> | <p>2. PSC shall clearly show the level of classified information, in which the person who has passed the security clearance procedure, can access. The PSC, for a certain level of classification, shall give the title holder access to information with the lowest classification level.</p> <p>3. Each head of the public institution shall be obliged, within 15 days, to implement the decision of the Verifying Authority and shall not provide access to classified information to a person who has been denied a PSC.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Criteria for Knowing the Classified Information</p> <p>1. The right to know, retain, manage and transfer classified information have only persons who:</p> <p>1.1 obtain the right of knowing by the head of the institution or the Contractor's Industrial Security Officer due to the duty they perform;</p> <p>1.2. are previously informed about the recognition of classified information security procedures and individual responsibilities for violations of security and have signed the statement of information retention;</p> | <p>2. BDO jasno ukazuje na stepen klasifikovanih informacija, kojem lice koje je prošlo proceduru bezbednosne provere može imati pristup. BDO za određeni stepen klasifikacije daje nosiocu pristup i informacijama sa nižim stepenom klasifikacije</p> <p>3. Svaki rukovodilac javne institucije je dužan da u roku od 15 dana sprovede odluku Organa za proveru i neće obezbediti pristup klasifikovanim informacijama licu kojem je uskraćen BDO.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Kriterijumi za saznanje klasifikovanih informacija</p> <p>1. Pravo na saznanje, čuvanje, upravljanje i prenos klasifikovanih informacija imaju samo lica, koja:</p> <p>1.1 obezbede pravo saznanja od strane rukovodioca institucije ili službenika za industrijsku bezbednost izvođača radova zbog dužnosti koju obavljaju;</p> <p>1.2. su prethodno obaveštena o saznanju postupaka bezbednosti klasifikovanih informacija i individualnih odgovornosti za kršenja bezbednosti i koji su potpisali izjavu o čuvanju informacija;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>1.3. janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”.</p> <p>2. Vetëm Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës janë të autorizuar të kenë qasje në informacione të klasifikuara pa iu nështruar verifikimit të sigurisë me kusht që:</p> <p>2.1 të kenë nevojë për të ditur informacionin e tillë;</p> <p>2.2 të jenë informuar për rregullat dhe procedurat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;</p> <p>2.3 të kenë pranuar se janë njoftuar në lidhje me përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe të kenë nënshkruar deklaratën e ruajtjes së informacionit.</p> | <p>1.3. are provided with CSP, except for cases with the recognition of classified information at the "Limited" level.</p> <p>2. Only the President of the Republic of Kosovo, the President of the Assembly of Kosovo and the Prime Minister shall be authorized to access classified information without being subjected to security verification provided that:</p> <p>2.1 need to know such information;</p> <p>2.2 be informed/briefed about the rules and security procedures for the protection of Classified Information;</p> <p>2.3 have acknowledged that they have been notified of their responsibilities for the protection of classified information and have signed the statement of information retention.</p> | <p>1.3 dobijaju CSP, osim u slučajevima priznavanja tajnih podataka na "ograničenom" nivou.</p> <p>2. Samo predsednik Republike Kosovo, predsednik Skupštine i premijer imaju ovlašćenje da imaju pristup klasifikovanim informacijama bez podvrgavanja proveri bezbednosti pod uslovom da:</p> <p>2.1 treba da znaju takve informacije;</p> <p>2.2 budu informisani o pravilima i sigurnosnim procedurama za zaštitu klasifikovanih informacija;</p> <p>2.3. da su potvrdili da su obaviješteni o svojim odgovornostima za zaštitu tajnih podataka i da su potpisali izjavu o čuvanju informacija.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 18 Listat e funksioneve/pozitave për njohjen e informacionit të klasifikuar</p> | <p style="text-align: center;">Article 18 Lists of functions/positions for knowing the classified information</p> | <p style="text-align: center;">Član 18 Spisak funkcija/pozicija za saznanje klasifikovanih informacija</p> |
| <p>1. Institucionet shtetërore të cilat, për shkak të veprimtarisë që kryejnë, prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera e përfitojnë këtë kategori informacioni, kanë për detyrë të miratojnë dhe të dërgojnë me shkrim në AMIK listën e</p> | <p>1. State institutions which, because of their activity, produce classified information or, while cooperating with other institutions benefit this category of information, have the duty to approve and send in writing to APCI a list of functions/positions that due to official duties can be</p> | <p>1. Državne institucije koje, zbog svoje delatnosti koju izvršavaju, proizvode klasifikovane informacije ili, u toku saradnje sa drugim institucijama dobijaju ovu kategoriju informacija, dužne su da odobre i pošalju u pisanoj formi AZKI-u spisak funkcija/pozicija</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>funksioneve/pozitive që për shkak të detyrave zyrtare mund të njihen me informacionin e klasifikuar dhe nivelin përkatës të CSP-së.</p> <p>2. Rishikimi i këtyre listave bëhet periodikisht dhe në përputhje me ndryshimet e strukturës organizative të institucionit përkatës. Për çdo ndryshim eventual, obligohet titullari i institucionit që ta njoftojë AMIK-un.</p> | <p>acquainted with classified information and relevant PSC level.</p> <p>2. The review of these lists shall be done periodically and in accordance with the changes in the organizational structure of the respective institution. For any eventual change, the head of the institution shall be obliged to notify APCI.</p> | <p>koje zbog službenih dužnosti mogu biti upoznate sa klasifikovanim informacijama i odgovarajućim nivoom BDO-a.</p> <p>2. Pregled ovih spiskova vrši se periodično i u skladu sa promenama organizacione strukture odgovarajuće institucije. O svakoj eventualnoj promeni, rukovodilac institucije je dužan da obavesti AZKI.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 19 Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë</p> <p>1. Verifikimi i sigurisë fillon vetëm pasi personi aplikues ka pranuar dhe ka dhënë pëlqimin me shkrim që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë, sipas kërkesave të pyetësorit të sigurisë.</p> <p>2. Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara në procesin e verifikimit të sigurisë kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> | <p style="text-align: center;">Article 19 Conditions for initiating the Security Clearance</p> <p>1. Security Clearance procedure shall commence only after the applicant has accepted and has given written consent to collect data and perform security clearance procedures, as per the security questionnaire requirements.</p> <p>2. The handling of personal data and information collected in the Security Clearance process shall be carried out in accordance with the requirements of the applicable Law on the Protection of Personal Data.</p> | <p style="text-align: center;">Član 19 Uslovi za početak bezbednosne provere</p> <p>1. Bezbednosna provera počinje tek nakon što je podnosilac zahteva prihvatio i dao pismenu saglasnost za prikupljanje podataka i izvršenje procedura bezbednosne provere, u skladu sa zahtevima bezbednosnog upitnika.</p> <p>2. Tretiranje ličnih podataka i informacija prikupljenih u procesu bezbednosne provere vrši se u skladu sa zahtevima važećeg zakona o zaštiti ličnih podataka.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 20 Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë</p> <p>1. AMIK-u si Autoritet i vetëm Verifikues në Republikën e Kosovës përgjegjës për zhvillimin e procedurës së verifikimit të sigurisë duhet t'iu përmbahet kërkesave të përgjithshme të vlerësimit</p> | <p style="text-align: center;">Article 20 General Security Assessment Requirements</p> <p>1. APCI, as the only Verifying Authority in the Republic of Kosovo responsible for conducting the Security Clearance Procedure, shall comply with</p> | <p style="text-align: center;">Član 20 Opšti zahtevi za bezbednosnu procenu</p> <p>1. AZKI, kao jedini organ za verifikaciju u Republici Kosovo odgovoran za sprovođenje procedure bezbednosne provere treba da se pridržava opštih zahteva za bezbednosnu</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>të sigurisë, të cilat janë, si më poshtë por nuk kufizohet në:</p> <p>1.1. Verifikimi i saktë i identitetit, të dhënat personale dhe statusit të shtetësisë, në të shkuarën dhe në të tashmen, për çdo person;</p> <p>1.2. Kontrolli i të dhënave, në funksion të sigurisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. Statusi financiar i aplikantit me qëllim të vlerësimit, nëse ai mund të ndodhet nën presion për shkak të paqëndrueshmërisë, vështirësive serioze financiare apo të zotërimit të ndonjë pasurie të pajustificuar;</p> <p>1.4. Informacioni për edukimin arsimor të personit pas moshës 18-vjeçare ose për periudhën e gjykuar si të përshtatshme nga autoriteti verifikues;</p> <p>1.5. Informacioni për punësimin e individit duke marrë në konsideratë referencat e punëve të mëparshme, bazuar në raportet e punëdhënësve;</p> <p>1.6. Informacioni për pjesëmarrjen në operacione ushtarake, kohëzgjatjen dhe arsyen e përfundimit të shërbimit në forcat e armatosura;</p> <p>1.7. Vlerësimi i përgjithshëm, nëse personi mund të vihet nën presion nga një faktor i jashtëm.</p> | <p>the General Security Assessment Requirements, which include, but are not limited to the following:</p> <p>1.1. The accurate verification of identity, generality and status of citizenship in the past and the present, for each person;</p> <p>1.2. The data control, in function of the security of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. The applicant's financial status, in order to verify whether he may be under pressure due to instability, serious financial difficulties or the possession of any unjustified property;</p> <p>1.4. The information on the education of a person after the age of 18 or for the period considered as appropriate by the verifying authority;</p> <p>1.5. The information on the employment of the individual taking into consideration the references from previous jobs, based on employer reports;</p> <p>1.6. The information on participation in military operations, the duration and the reason of termination of service in the military;</p> <p>1.7. The overall assessment of whether a person may be pressured by an unfriendly foreign force.</p> | <p>procenu, koji su dati u nastavku, ali ne ograničavaju se na sledeće:</p> <p>1.1. Tačna provera identiteta, generalija i statusa državljanstva u prošlosti i sadašnjosti, za svaku osobu;</p> <p>1.2. Kontrola podataka, u funkciji bezbednosti Republike Kosovo;</p> <p>1.3. Finansijski status podnosioca zahteva, kako bi se utvrdilo da li može biti pod pritiskom zbog nestabilnosti, ozbiljnih finansijskih poteškoća ili posedovanja bilo koje neopravdane imovine;</p> <p>1.4. Informacije o obrazovanju osobe nakon 18 godina starosti ili za period koji se smatra odgovarajućim od strane organa za verifikaciju;</p> <p>1.5. Informacije o zapošljavanju pojedinca uzimajući u obzir reference ranijih radnih mesta, na osnovu izveštaja poslodavaca;</p> <p>1.6. Informacije o učešću u vojnim operacijama, trajanje i razlog za otkaz službe u oružanim snagama;</p> <p>1.7. Sveukupna procena o tome da li osoba može biti stavljena pod pritiskom neprijateljske strane.</p> |
|---|---|--|

| <p align="center">Neni 21 Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë</p> | <p align="center">Article 21 Essential Security Assessment Criteria</p> | <p align="center">Član 21 Osnovni kriterijumi za bezbednosnu procenu</p> |
|---|--|--|
| <p>1. Kriteret themelore, mbi bazën e të cilave vlerësohet ekzistenca ose jo e rrezikut të papranueshëm të sigurisë për informacionet e klasifikuara që shërbejnë si bazë për të lëshuar, pezulluar apo refuzuar pajisjen ose mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, janë rastet kur një individ rezulton se:</p> <p>1.1. ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim apo në përbërje të një organizate ilegale, në veprimtari spiunazhi, terrorizmi, tradhtie, rebelimi, sabotimi apo dhune të armatosur ndaj rendit kushtetues apo ka nxitur aktivisht dikë të kryejë veprimtari spiunazhi, terrorizmi, tradhtie, rebelimi apo dhune të armatosur ndaj rendit kushtetues;</p> <p>1.2. është apo ka qenë bashkëpunëtor në spiunazh, terrorizëm, tradhti, rebelim, sabotim apo dhunë të armatosur ndaj rendit kushtetues, ka dyshime të ketë qenë i tillë apo bashkëpunëtor i përfaqësuesve të organizatave, shteteve të huaja, duke përfshirë këtu shërbimet e inteligjencës të cilat mund të cenojnë sigurinë e vendit tonë dhe/ose të shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të Bashkimit Evropian, përveç rasteve kur këto</p> | <p>1. The essential criteria, used to assess existence or non-existence of an unacceptable security risk for classified information, which serve as the grounds for issuing, suspending or rejecting the equipment or holding of a PSC, are the cases where an individual results to:</p> <p>1.1. have been, is or is trying to secretly engage, alone, in collaboration or as part composition of an illegal organization, in espionage, terrorism, betrayal, rebellion or armed violence against the constitutional order or has actively encouraged someone to engage in espionage, terrorism, betrayal, rebellion, sabotage or armed violence against the constitutional order;</p> <p>1.2. has been or is a collaborator of espionage, terrorism, betrayal, rebellion, sabotage or armed violence against the constitutional order, there are suspicions that he/she has been a collaborator of representatives of organizations, foreign states, including intelligence services, which may violate the security of our country and/or NATO and EU Member States, unless such collaborations are authorized due to the duty;</p> | <p>1. Osnovni kriterijumi na osnovu kojih se procenjuje postojanje ili nepostojanje neprihvatljivog bezbednosnog rizika za klasifikovane informacije koje služe kao osnova za izdavanje, obustavljanje ili odbijanje pružanja ili daljeg zadržavanja BDO-a, su slučajevi u kojima pojedinac rezultira da:</p> <p>1.1. je bio, jeste ili pokušava da se tajno angažuje, sam ili u saradnji ili u sastavu ilegalne organizacije u aktivnostima špijunaže, terorizma, izdaje, pobune, sabotaze ili oružanog nasilja protiv ustavnog poretka ili aktivno podstiče nekoga da izvrši dela špijunaže, terorizma, izdaje, pobune ili oružanog nasilja protiv ustavnog poretka;</p> <p>1.2. jeste ili je bio saučesnik u špijunaži, terorizmu, izdaji, pobuni, sabotaze ili oružanom nasilju protiv ustavnog poretka, postoje sumnje da je bio takav ili saradnik predstavnika organizacija, stranih država, uključujući obaveštajne službe koje mogu ugroziti bezbednost naše zemlje i/ili država članica NATO-a, EU-a, osim ako je takva saradnja odobrena zbog dužnosti;</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>bashkëpunime janë të autorizuara për shkak të detyrës;</p> <p>1.3. është apo ka qenë anëtar i një organizate, e cila me mjete të dhunshme, armiqësore, të paligjshme, ka qëllim të rrëzojë qeverinë apo të ndryshojë rendin kushtetues;</p> <p>1.4. është apo ka qenë mbështetës i një organizate të përshkruar si në pikën 1.3, të këtij neni, ose është apo ka qenë i/e lidhur ngushtë me ndonjë anëtar të një organizate të tillë;</p> <p>1.5. qëllimisht ka fshehur, ka keq prezantuar apo ka falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo qëllimisht ka gënjyer gjatë plotësimit të pyetësorit të sigurisë apo intervistës së sigurisë;</p> <p>1.6. rezulton i dënuar për një ose më shumë vepra penale të kryera me dashje.</p> <p>1.7. ka një historik varësie nga alkooli, përdorimi i drogave të jashtëligjshme, apo keqpërdorimi i drogave të ligjshme;</p> <p>1.8. ka sjellje të keqe, tendenca kriminale e përfshirje në krim të organizuar, gjë që sjell rrezikun e dobësisë përballë shantazhit apo mund të influencohet seriozisht nga presione të ndryshme;</p> | <p>1.3. has been or is a member of an organization that, by violent, hostile, illegal means, intends to overthrow the government or change the constitutional order;</p> <p>1.4. has been or is a supporter of an organization as described in point 1.3 of this Article, or has been or is closely associated with any member of such an organization;</p> <p>1.5. has intentionally concealed, misrepresented or falsified information of major importance, of a particular security nature or intentionally lied during the completion of a security questionnaire or a security interview;</p> <p>1.6. Has been convicted for one or more intentionally committed criminal offenses.</p> <p>1.7. has a background of addiction to alcohol, use of illegal drugs, or abuse of legal drugs;</p> <p>1.8. has bad ethics, criminal tendencies, and involvement in organized crime, which bears risk of weakness toward blackmail or can be seriously influenced under different pressures;</p> | <p>1.3. jeste ili je bio član organizacije koja nasilnim, neprijateljskim i nezakonitim sredstvima namerava srušiti Vladu ili promeniti ustavni poredak;</p> <p>1.4. jeste ili je podržavao organizaciju kako je opisano u tački 1.3 ovog člana, ili jeste ili je bilo blisko povezan sa bilo kojim članom takve organizacije;</p> <p>1.5. namerno je sakrivao, pogrešno predstavio ili je falsifikovao informacije od velikog značaja, određene bezbednosne prirode ili je namerno slagao prilikom popunjavanja bezbednosnog upitnika ili tokom bezbednosnog intervjuja;</p> <p>1.6. rezultira osuđenim za jedno ili više namerno izvršenih krivičnih dela.</p> <p>1.7. ima istoriju zavisnosti od alkohola, upotrebe ilegalnih droga ili zloupotrebe legitimnih droga;</p> <p>1.8. ima loše ponašanje, kriminalne tendencije i učešće u organizovanom kriminalu, što dovodi do rizika od slabosti naspram ucene ili može da bude pod ozbiljnim uticajem različitih pritisaka;</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>1.9. me anë të veprimeve konkrete ka shprehur mungesë besnikërie, besueshmërie dhe sigurie;</p> <p>1.10. ka kryer shkelje sigurie, në mënyrë të përsëritur ka nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar ka tentuar apo ka arritur të kryejë aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar;</p> <p>1.11. vuan nga çrregullime mendore.</p> <p>2. Sjellja dhe rrethanat e bashkëshortit, bashkëjetuesit ose anëtarit të ngushtë të familjes mund të konsiderohen relevante edhe gjatë vlerësimit të sigurisë.</p> | <p>1.9. through concrete actions has expressed a lack of loyalty, trustworthiness, and security;</p> <p>1.10. has committed a security breach or has repeatedly violated classified information security rules or has attempted and managed to perform an unauthorized activity in the classified information communication systems;</p> <p>1.11. Suffers from chronic mental illness.</p> <p>2. The behavior and circumstances of a spouse, cohabitant or close family member may also be considered relevant when assessing the safety.</p> | <p>1.9. konkretnim radnjama izrazio je nedostatak lojalnosti, pouzdanosti i sigurnosti;</p> <p>1.10. izvršio je povredu bezbednosti ili je u više navrata prekršio pravila bezbednosti klasifikovanih informacija ili je pokušao i uspeo da izvrši neovlašćene aktivnosti u sistemima komunikacije klasifikovanih informacija;</p> <p>1.11. pati od hroničnih mentalnih poremećaja.</p> <p>2. Ponašanje i okolnosti supružnika, osobe sa kojom živi zajedno ili užeg člana porodice mogu se takođe smatrati relevantnim prilikom procene bezbednosti.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 22 Intervista e sigurisë</p> <p>1. AMIK-u mund të zhvillojë intervista me persona të cilët kanë aplikuar për t'u pajisur me CSP dhe në drejtim të tyre janë ndërmarrë procedurat e verifikimit të sigurisë.</p> <p>2. AMIK-u mund të zhvillojë intervista me persona të tretë të paanshëm, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e personit që i është nënshtruar verifikimit të sigurisë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 22 Security Interview</p> <p>1. APCI may conduct interviews with persons who have applied to be equipped with a PSC and security clearance procedures have been undertaken in this regard.</p> <p>2. APCI may conduct interviews with third impartial parties, who know the past and the activities of the person who has been subject to Security clearance.</p> | <p style="text-align: center;">Član 22 Bezbednosni intervju</p> <p>1. AZKI može obaviti intervju sa licima koja su podnela zahtev za dobijanje BDO-a i prema njima su preduzete procedure za bezbednosnu proveru.</p> <p>2. AZKI može obaviti intervju sa trećim nepristrasnim licima, kojima je poznata prošlost i aktivnosti lica koje podleže bezbednosnoj proveru.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 23 Vlefshmëria e CSP</p> <p>1. CSP e nivelit TEPËR SEKRET vlenë për periudhën pesë (5) vjeçare nga data e lëshimit të saj.</p> <p>2. CSP e nivelit SEKRET vlenë për periudhën shtatë (7) vjeçare nga data e lëshimit të saj.</p> <p>3. CSP e nivelit KONFIDENCIAL vlenë për periudhën dhjetë (10) vjeçare nga data e lëshimit të saj.</p> | <p style="text-align: center;">Article 23 Validity of PSC</p> <p>1. The TOP SECRET PSC shall be valid for a 5 year period from the date of its issuance.</p> <p>2. The SECRET PSC shall be valid for a 7 year period from the date of its issuance.</p> <p>3. The CONFIDENTIAL PSC shall be valid for a 10 year period from the date of its issuance.</p> | <p style="text-align: center;">Član 23 Validnost BDO-a</p> <p>1. BDO stepena STROGA TAJNA važi za petogodišnji period od dana njegovog donošenja;</p> <p>2. BDO stepena TAJNA važi za sedmogodišnji period od dana njegovog donošenja;</p> <p>3. BDO stepena POVERLJIVO važi za desetogodišnji period od dana njegovog donošenja.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 24 Zgjatja e afatit të CSP-së në rrethanat e urgjencës</p> <p>1. Në kushtet e rrethanave të urgjencës, AMIK-u ka të drejtë të zgjatë afatin e CSP-së së një individi vetëm një herë, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike gjatë ciklit të vlefshmërisë së saj, me kushtet e mëposhtme:</p> <p>1.1. Personi, për të cilin kërkohet zgjatja e afatit, duhet të mbajë një CSP të vlefshme, lëshuar me procedurë të plotë. Përrjashtohen rastet e zgjatjes së afateve për një CSP e cila është e lëshuar në kushtet e rrethanave të urgjencës.</p> <p>1.2. Ekziston një kërkesë zyrtare që sqaron rrethanat e urgjencës dhe provon rrethanat e pamundësisë për të aplikuar sipas</p> | <p style="text-align: center;">Article 24 Extending the PSC validity period in cases of urgency extraordinary emergent situations</p> <p>1. Under exceptional emergency circumstances, the APCI has the right to extend an individual's PSC validity period only one time, for up to 60 calendar days during its validity cycle under the following conditions:</p> <p>1.1. The individual, which requires the extension of the validity period, must have a valid PSC, issued in full procedure. The extensions of the validity period for a PSC issued under circumstances of urgency extraordinary emergency are exempted.</p> <p>1.2. There is an official request clarifying the circumstances of extraordinary emergency and proves that circumstances do not allow applying</p> | <p style="text-align: center;">Član 24 Produženje roka BDO-a u okolnostima vanrednog stanja</p> <p>1. U okolnostima vanrednog stanja, AZKI ima pravo da produži rok važenja DBO-a samo jednom, do 60 kalendarskih dana tokom ciklusa njegovog važenja pod sledećim uslovima:</p> <p>1.1. Lice, za koga se traži produženje roka, treba da poseduje važeći DBO, koji je izdat odgovarajućom procedurom. Isključeni su slučajevi produženja roka za jedan DBO koji je izdat u okolnostima vanrednog stanja;</p> <p>1.2. Postoji zvaničan zahtev koji objašnjava okolnosti vanrednog stanja i dokazuje okolnosti nemogućnosti primene u skladu sa</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>procedurave normale për ripajisjen me CSP të re, kur:</p> <p>1.3. një person ndodhet në kushtet e ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare, për të cilën ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;</p> <p>1.4. një person ka nevojë për pjesëmarrje në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, për të cilin ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;</p> <p>1.5. një person, i cili ka qenë i pajisur me CSP, ndodhet në kushtet e zgjatjes së afateve të pjesëmarrjes në misione ushtarake jashtë vendit dhe të pamundësisë për të aplikuar, sipas procedurave normale për ripajisjen me CSP të re. Zgjatja e afateve të CSP-së me kushtëzimet e sipërpërmendura lejohet për CSP-në e nivelit “Konfidencial”, “Sekret” dhe “Tepër sekret”.</p> <p>2. Të gjithë personave të cilëve iu është vazhduar CSP në rrethanat dhe kushtet e jashtëzakonshme, obligohen që në formë të shkruar të deklarohen se i kanë kuptuar të gjitha obligimet e tyre për ruajtjen e informacionit të klasifikuar.</p> | <p>under normal procedures for re-equipped with a new PSC, when:</p> <p>1.3. an individual is exercising a short-term official duty, for which it was impossible to follow the procedures according to foreseen time limits;</p> <p>1.4. an individual needs to participate in an unpredicted international activity, which has rendered impossible to follow the procedures according to foreseen time limits;</p> <p>1.5 an individual, who was equipped with a PSC, is in the circumstance that requires extending the time limits for participating in military missions abroad and it is impossible to apply according to normal procedures for re-obtaining a new PSC. The extension of the PSC validity period under the aforementioned conditions is allowed for the PSCs of “Confidential”, “Secret” and “Highly Secret” levels.</p> <p>2. All individuals to whom the PSC has been extended under extraordinary circumstances and conditions are obliged to state, in the writing, that they have understood all their obligations to protect the classified information.</p> | <p>normalnim procedurama za ponovno dobijanje novog BDO-a, kada je:</p> <p>1.3 lice je u uslovima izvršenja kratkoročnog službenog zadatka, o kojem je bilo nemoguće pratiti procedure, u skladu sa predviđenim vremenskim rokovima;</p> <p>1.4. lice treba da učestvuje u nepredviđenim međunarodnim aktivnostima za koje je bilo nemoguće pratiti procedure prema predviđenim vremenskim rokovima;</p> <p>1.5 lice, koje je dobilo DBO, se nalazi u uslovima produženja roka za učešće u vojnim misijama van zemlje i nemogućnosti primene u skladu sa normalnim procedurama za dobijanje novog DBO-a. Produženje rokova DBO-a pod gore navedenim uslovima je dozvoljeno za DBO-e stepena “Poverljivo”, “Tajna” i “Stroga tajna”.</p> <p>2. Sva lica kojima je DBO produžen u vanrednim okolnostima i uslovima dužna su da se u pisanoj formi izjasne da su shvatila sve svoje obaveze o čuvanju klasifikovanih informacija.</p> |
|---|---|--|

| <p align="center">Neni 25 Përsëritja e Verifikimit të Sigurisë</p> | <p align="center">Article 25 Repetition of Security Clearance</p> | <p align="center">Član 25 Ponavljanje bezbednosne provere</p> |
|---|---|---|
| <p>1. Personat të cilëve u është lëshuar CSP i nënshtrohen një verifikimi të ri të sigurisë në intervalet e rregullta si në vijim:</p> <p>1.1. çdo dhjetë (10) vjet për personat me CSP të sigurisë që u lejon atyre qasje në informacionet e klasifikuara në nivelin “KONFIDENCIALE”;</p> <p>1.2. çdo shtatë (7) vjet për personat me CSP që u lejon atyre qasje në informacionet e klasifikuara në nivelin “SEKRET”;</p> <p>1.3. çdo pesë (5) vjet për personat me CSP që u lejon atyre qasje në informacionet e klasifikuara në nivelin “TEPËR SEKRET”.</p> <p>2. Autoriteti Verifikues apo drejtuesi i institucionit publik, ku personi i verifikuar është i punësuar, mund t’i kërkojë këtij personi që t’i nënshtrohet një procedure të re të verifikimit të sigurisë madje edhe para skadimit të vlefshmërisë së CSP nëse ai/ajo ka indikacione që kanë ndodhur ngjarje apo janë paraqitur rrethana që ngrisin dyshim nëse personi i verifikuar ende përbën rrezik të pranueshëm për sigurinë.</p> | <p>1. The persons to whom a PSC has been issued are subject to new security clearances during the following regular intervals:</p> <p>1.1. every ten (10) years for persons with PSC of security that allows them access to classified information at “CONFIDENTIAL” level;</p> <p>1.2. every seven (7) years for persons with PSC of security that allows them access to classified information at “SECRET” level;</p> <p>1.3. Every five (5) years for persons with PSC of security that allows them access to classified information at “HIGHLY SECRET” level.</p> <p>2. The Verifying Authority or the head of the public institution, where the verified person is employed, may require that person to undergo a new Security clearance procedure even before the PSC validity expires, if there are indications that events have taken place or there are circumstances that raise doubts whether the verified person still constitutes an acceptable security risk.</p> | <p>1. Lica kojima je izdat DBO podležu novoj bezbednosnoj proveri u sledećim redovnim intervalima:</p> <p>1.1. svakih deset (10) godina za lica sa DBO-om bezbednosti koja im omogućuje pristup klasifikovanim informacijama stepena “POVERLJIVO”;</p> <p>1.2. svakih sedam (7) godina za lica sa DBO-om koja im omogućuje pristup klasifikovanim informacijama stepena “TAJNA”;</p> <p>1.3. svakih pet (5) godina za lica sa DBO-om koje im omogućuje pristup klasifikovanim informacijama stepena “STROGA TAJNA”.</p> <p>2. Organ za proveru ili rukovodilac javne institucije u kojoj je zaposleno provereno lice može zatražiti od tog lica da se podvrgne novoj proceduri bezbednosne provere čak i pre isteka važenja DBO-a ako postoje indikacije događaja koji su se desili ili okolnosti koje izazivaju sumnju o tome da li proverena osoba i dalje predstavlja prihvatljiv bezbednosni rizik.</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 26 Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP-së</p> <p>1. AMIK-u merr vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së, në rastet kur ka pranuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP-së nga një person i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kritereve të përgjithshme dhe themelore të vlerësimit të sigurisë.</p> <p>2. Njoftimi për vendimin e marrë nga AMIK-u për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP-së i komunikohet me shkrim titullarit institucionit përkatës publik i cili ka iniciuar kërkesën për zhvillimin e procedurës së verifikimit të sigurisë.</p> <p>3. Procedurat për verifikimin e sigurisë së personelit përcaktohen me akt nënligjor të propozuar nga AMIK dhe të miratuar nga Qeveria.</p> | <p style="text-align: center;">Article 26 Refusal, Revocation, and temporary Suspension of PSC</p> <p>1. APCI shall take a decision on refusal, revocation or suspension of PSC in cases where they have received information inferring that the equipment or possession of PSC by a specific person constitutes an unacceptable security risk in referral to the general and fundamental criteria of security assessment.</p> <p>2. The notification of the decision taken by APCI to refuse, revoke or suspend the PSC is communicated in writing to the head of the concerned public institution which has initiated the request for performing the Security clearance procedure.</p> <p>3. The procedures for verifying the security of personnel shall be determined by a sublegal act proposed by AMIK and approved by the Government.</p> | <p style="text-align: center;">Član 26 Privremeno odbijanje, opoziv i obustavljanje DBO-a</p> <p>1. AZKI donosi odluku o odbijanju, otkazivanju ili privremenoj obustavi DBO-a u slučajevima kada je dobila informaciju kojom se smatra da izdavanje ili dalje držanje DBO-a od strane određenog lica predstavlja neprihvatljiv bezbednosni rizik, pozivajući se na opšte i osnovne kriterijume bezbednosne procene.</p> <p>2. Obaveštenje o odluci koju je doneo AZKI o odbijanju, opozivu ili privremenom obustavljanju SBO-a pismeno se dostavlja rukovodiocu odgovarajuće javne institucije koja je podnela zahtev za vođenje postupka bezbednosne provere.</p> <p>3. Procedure za proveru bezbednosti osoblja se definišu podzakonskim aktom predloženim od strane AZKI</p> |
| <p>Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit kontrollohet dhe mbrohet në përputhje me nivelin e klasifikimit të Informacionit për të cilin lejon qasjen;</p> <p>1.3. Kontrollon qasjen në informacion të klasifikuar në përputhje me parimin “nevojë për njohje”;</p> <p>1.4. Menaxhimin e Integritetit, origjinës dhe disponueshmërisë së informacionit të klasifikuar</p> <p>1.5. Kontrollin e lidhjeve të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit që trajtojnë informacion të klasifikuar;</p> <p>1.6. Përcaktimin e nivelit të besueshmërisë së mekanizmave mbrojtës të sigurisë së Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit;</p> <p>1.7. Vlerësimin dhe verifikimin e funksionimit të saktë të mekanizmave mbrojtës të sigurisë së Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit përgjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre;</p> <p>1.8. Hetimin e aktivitetit të përdoruesve dhe të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit;</p> | <p>Communication and Information Systems shall be controlled and protected in compliance with the information classification level to which the system grants access;</p> <p>1.3. Controls access to classified information in accordance with the "need to know" principle;</p> <p>1.4. Management of integrity, origin and availability of classified information</p> <p>1.5. Controlling of Communication and Information System connections that handle Classified Information;</p> <p>1.6. Determining the Communication and Information System’s security mechanisms reliability level;</p> <p>1.7. Assesses and verifies the proper functioning of the Information and Communication System’s security protection mechanisms, throughout their lifespan;</p> <p>1.8. Investigation of users and communication and information systems activities;</p> | <p>informacionim sistemima je kontrolisana i zaštićena u skladu sa stepenom poverljivosti informacije za koju odobrava pristup.</p> <p>1.3. Kontrolisanje pristupa klasifikovanim informacijama u skladu sa principom “nužnost pristupa informacijama”</p> <p>1.4. Upravljanje integritetom, poreklom i dostupnošću klasifikovanih informacija;</p> <p>1.5. Kontrolu povezivanja komunikacionih i informacionih sistema koji tretiraju klasifikovane informacije;</p> <p>1.6. Utvrđivanje stepena pouzdanosti zaštitnih mehanizama bezbednosti komunikacionih i informacionih sistema;</p> <p>1.7. Procenu i proveru tačnog funkcionisanja zaštitnih mehanizama bezbednosti komunikacionih i informacionih sistema tokom njihovog celokupnog životnog veka;</p> <p>1.8. Istraživanje aktivnosti korisnika i komunikacionih i informacionih sistema;</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.9. Garantimin e jo-mohueshmërisë që dërguesi i informacionit të pajisjet me vërtetimin e marrjes së mesazhit nga marrësi dhe marrësi të pajiset me vërtetimin e identitetit të dërguesit;</p> <p>1.10. Sigurimin që në rast të shkeljes së sigurisë të gjithë personat juridik dhe fizik të përfshirë, informohen se informacioni është cenuar.</p> | <p>1.9. Ensuring that the receiver of the message provides the sender with the acknowledgement of the message (non-deniability of message acknowledgement) and that the receiver is provided with the sender's identity confirmation;</p> <p>1.10. Ensure that in case of a breach of security all legal and natural persons involved are informed that the information was violated.</p> | <p>1.9. Garantovanje neporicanja kako bi pošiljalac informacija dobio potvrdu o preuzimanju poruke od strane primaoca i da primalac dobije potvrdu o identitetu pošiljaoca;</p> <p>1.10. Obezbeđivanje da u slučaju kršenje bezbednosti sva uključena pravna i fizička lica budu obavestena da je informacija prekršena.</p> |
| <p style="text-align: center;">KAPITULLI VI SIGURIA FIZIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Siguria Fizike</p> | <p style="text-align: center;">CHAPTER VI PHYSICAL SECURITY</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Physical Security</p> | <p style="text-align: center;">POGLAVLJE VI FIZIČKA BEZBEDNOST</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Fizička bezbednost</p> |
| <p>1. Siguria fizike është tërësia e masave fizike, teknike, elektronike dhe procedurale për ruajtjen e zonave, ndërtesave, zyrave, dhomave, hapësirave dhe pajisjeve ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar, duke përfshirë edhe procesin e menaxhimit të rrezikut për parandalimin e qasjes së paautorizuar në zonat e sigurisë.</p> <p>2. Institucionet shtetërore kanë për detyrë të marrin masa për sigurimin fizik të zonave, ndërtesave, zyrave, dhomave, hapësirave dhe pajisjeve ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet</p> | <p>1. Physical security shall mean the set of physical, technical, electronic and procedural measures undertaken for the purpose of safeguarding areas, buildings, offices, rooms, spaces and equipment where the Classified Information is produced, recorded, used, transmitted, stored, archived and destroyed, including the risk management process for preventing unauthorized access to security areas.</p> <p>2. State institutions are obliged to take measures for physical security of areas, buildings, offices, rooms, spaces and equipment where classified information is produced, recorded, used, transmitted, stored, archived and destroyed, in accordance with the</p> | <p>1. Fizička bezbednost predstavlja skup fizičkih, tehničkih, elektronskih i proceduralnih mera za očuvanje područja, zgrada, kancelarija, soba, prostorija i uređaja u kojima se proizvodi, snima, koristi, prenosi, čuva, arhivira ili uništava klasifikovana informacija, uključujući i proces upravljanja rizikom za sprečavanje neovlašćenog pristupa sigurnosnim zonama</p> <p>2. Državne institucije su obavezne da preduzimaju mere za fizičku bezbednost područja, zgrada, kancelarija, soba, prostorija i uređaja u kojima se proizvodi, snima, koristi, prenosi, čuva, arhivira ili uništava klasifikovana</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>informacioni i klasifikuar, në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara përmes akteve nënligjore, i cili është në përputhje me standardet relevante të përcaktuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të Bashkimit Evropian.</p> <p>3. Titullari i institucionit miraton me urdhër ndarjen e zonave të sigurisë i cili shoqërohet me planin dhe skemën e sigurisë fizike të objektit ku mbahet dhe administrohet informacioni i klasifikuar.</p> <p>4. Në Institucionet shtetërore ku punohet me informacionin e klasifikuar në varësi të volumit të informacionit të klasifikuar, krijohet strukturë e sigurisë/zyrtar i sigurisë.</p> <p>5. AMIK në bashkëpunim me institucionet shtetërore në mënyrë periodike kryen dezinfektimin elektronik të ndërtesave, zyrave, dhomave, ambienteve ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar.</p> <p>6. Rregullat për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar, përcaktohet me akt nënligjor.</p> | <p>standards and procedures established by sub-legal acts, which are in compliance with relevant standards determined by the North Atlantic Treaty Organization and the European Union.</p> <p>3. The head of the institution shall approve the division of security areas by means of an Order, which shall be accompanied by the physical security plan and scheme of the building where classified information is stored and managed.</p> <p>4. State institutions where classified information is processed, shall establish security structures/security officers, depending on the volume of classified information.</p> <p>5. In cooperation with state institutions, APCI shall periodically conduct electronic disinfection of buildings, offices, rooms, and premises where the Classified Information is produced, recorded, used, transmitted, stored, archived and destroyed.</p> <p>6. The rules for the physical transport of classified information shall be defined by a sub-legal act.</p> | <p>informacija, u skladu sa standardima i procedurama utvrđenim podzakonskim aktima, koji su u skladu sa relevantnim standardima koji su utvrđeni od strane Organizacije severnoatlantskog ugovora i Evropske unije.</p> <p>3. Rukovodilac institucije nalogom odobrava podelu bezbednosnih zona koji je praćen planom i šemom fizičke bezbednosti objekta u kom se čuvaju i upravljaju klasifikovane informacije.</p> <p>4. U državnim institucijama u kojima se radi sa klasifikovanim informacijama, u zavisnosti od obima klasifikovanih informacija, uspostavlja se bezbednosna struktura/slужbenik za bezbednost.</p> <p>5. AZKI, u saradnji sa državnim institucijama, periodično vrši elektronsku dezinfekciju zgrada, kancelarija, soba, prostorija u kojima se proizvodi, snima, koristi, prenosi, čuva, arhivira ili uništava klasifikovana informacija.</p> <p>6. Pravila fizičkog prevoza klasifikovanih informacija utvrđuju se podzakonskim aktom.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 46 Njësia e informacionit të klasifikuar</p> <p>1. Çdo institucion publik që prodhon dhe administron informacion të klasifikuar, duhet që brenda organizimit të strukturës së vetë të caktojë zyrtarin apo njësinë përkatëse si dhe të sigurojë zyrat apo hapësirat përkatëse, ku mbahet dhe administrohet informacioni i klasifikuar.</p> <p>2. Institucionet publike mbajnë Regjistrat për informacionin e klasifikuar sipas modelit të përcaktuar nga Agjencia.</p> <p>3. Modeli për shenjëzimin e informacioneve të klasifikuara është unik dhe përcaktohet nga AMIK dhe obligohen të gjitha institucionet publike për zbatimin e tij.</p> <p>4. Procesi i themelimit, mbajtjes dhe administrimit të njësisë apo zyrtarit përkatës, zyrave apo hapësirat përkatëse duke përfshirë edhe mbajtjen e Regjistrave për informacionin e klasifikuar, përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, sipas propozimit të Agjencisë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 46 Classified Information Unit</p> <p>1. Any public institution that produces and manages classified information must, within its own structure, appoint an officer or unit and provide the appropriate offices or premises where classified information is maintained and administered.</p> <p>2. Public institutions shall maintain Registers for classified information according to the model established by the Agency.</p> <p>3. The model for marking classified information shall be unique and determined by APCI and all public institutions shall be obliged to implement it.</p> <p>4. The process of establishing, maintaining and managing the unit or concerned officer, offices or respective premises, including the maintenance of Registers for Classified Information, shall be determined by a sub-legal act approved by the Government, upon proposal of the Agency.</p> | <p style="text-align: center;">Član 46 Jedinica za klasifikovane informacije</p> <p>1. Svaka javna institucija koja proizvodi i upravlja klasifikovanim informacijama mora da u okviru strukture svoje organizacije odredi odgovarajućeg službenika ili jedinicu, kao i da obezbedi odgovarajuće kancelarije ili prostorije koje služe za održavanje i upravljanje klasifikovanim informacijama.</p> <p>2. Javne institucije vode Registre za klasifikovane informacije prema modelu koji je utvrdila Agencija.</p> <p>3. Model za obeležavanje klasifikovanih informacija je jedinstven i isti utvrđuje AZKI, a sve javne institucije su obavezne da ga primenjuju.</p> <p>4. Proces uspostavljanja, održavanja i upravljanja odgovarajućom jedinicom ili službenikom, odgovarajućim kancelarijama ili prostorijama, uključujući i vođenje Registara za klasifikovane informacije, utvrđuje se podzakonskim aktom koji usvaja Vlada na predlog Agencije.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 47 Regjistrat</p> <p>Çdo drejtues i institucionit publik që prodhon dhe administron informacion te klasifikuar duhet të</p> | <p style="text-align: center;">Article 47 Registers</p> <p>Any head of a public institution that generates and manages classified information should establish minimum security standards for protection of</p> | <p style="text-align: center;">Član 47 Registri</p> <p>Svaki rukovodilac javne institucije, koja proizvodi i upravlja klasifikovanim</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>krijojë standardet minimale të sigurisë të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, si dhe të caktojë persona përgjegjës për administrimin e këtyre informacioneve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Informacioni i huaj</p> <p>1. Institucionet shtetërore e ruajnë informacionin e klasifikuar të shteteve të huaja apo të organizatave ndërkombëtare sipas standardeve që sigurojnë një shkallë mbrojtjeje, të njejtë me atë që kërkohet nga shteti apo organizata ndërkombëtare.</p> <p>2. Çdo institucion, përpara nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokollit teknik që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të marrë më parë mendimin e AMIK.</p> <p>3. Nënshkrimi i një marrëveshjeje apo protokollit teknik, që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të jetë paraprirë nga nënshkrimi i marrëveshjes së përgjithshme për sigurimin e informacionit të klasifikuar midis autoriteteve të sigurisë kombëtare të shteteve palë.</p> | <p>classified information and appoint persons responsible for managing such information.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Foreign information</p> <p>1. State institutions shall safeguard classified information of foreign states or international organizations pursuant to standards that provide a degree of protection that is equivalent to that required by the state or international organization.</p> <p>2. Any institution shall, prior to the signing of an agreement or technical protocol involving the exchange of Classified Information, consider the opinion of APCI.</p> <p>3. The signing of a technical agreement or protocol involving the exchange of classified information shall be preceded by the signature of a general agreement on the provision of classified information between the national security authorities of the States Parties.</p> | <p>informacijama, mora da stvori minimalne bezbednosne standarde za zaštitu klasifikovanih informacija, kao i da odredi odgovorna lica za upravljanje ovim informacijama.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Strane informacije</p> <p>1. Državne institucije čuvaju klasifikovane informacije stranih država ili međunarodnih organizacija prema standardima koji obezbeđuju stepen zaštite koji je isti sa stepenom zaštite koji zahteva država ili međunarodna organizacija.</p> <p>2. Svaka institucija, pre potpisivanja sporazuma ili tehničkog protokola koji obuhvata razmenu klasifikovanih informacija, mora najpre da dobije mišljenje AZKI-a.</p> <p>3. Potpisivanju sporazuma ili tehničkog protokola, koji obuhvata razmenu klasifikovanih informacija, mora da prethodi potpisivanje opšteg sporazuma za bezbednost klasifikovanih informacija između organa nacionalne bezbednosti država ugovornica.</p> |
|---|---|---|

| <p align="center">Neni 49 Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së</p> | <p align="center">Article 49 NATO and EU classified information</p> | <p align="center">Član 49 Klasifikovane informacije NATO-a i EU-a</p> |
|---|---|---|
| <p>1. Sistemi i Regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së përbehet nga Zyra e Regjistrimit Qendror në AMIK, Zyrat e Nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s e BE-së dhe pikat e kontrollit, që krijohen në ministri dhe institucione shtetërore.</p> <p>2. Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së shkëmbehet dhe administrohet vetëm përmes këtij Sistemi.</p> <p>3. Sistemi i Regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së është përgjegjës për regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n dhe BE-në.</p> <p>4. Institucionet shtetërore janë të obliguara që ta mbrojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe të BE-se sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjtë me atë që kërkohet respektivisht nga NATO-ja dhe BE-ja.</p> <p>5. Zyra e Regjistrimit Qendror të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së në AMIK është struktura përgjegjëse për drejtimin e shkëmbimit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e aspekteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së brenda Sistemit të Regjistrimit.</p> | <p>1. The NATO and EU's classified information Registry System shall consist of the Central Registry Office in APCI, the Sub-register Office of NATO and EU classified information, and control points established in the Ministry and state institutions.</p> <p>2. NATO and EU classified information shall be exchanged and managed only through this System.</p> <p>3. NATO and EU classified information Register System shall be responsible for the registration, distribution and administration of classified information exchanged in the framework of cooperation with NATO and the EU.</p> <p>4. State institutions shall be obliged to protect NATO and EU classified information according to standards that provide a level of protection equivalent to that required by NATO and the EU respectively.</p> <p>5. The Central Registry Office of NATO and EU classified information in APCI shall be the structure responsible for managing the exchange, oversight and control of the security aspects of NATO and EU classified information within the Register System.</p> | <p>1. Sistem Registra klasifikovanih informacija NATO-a i EU-a sastoji se od Kancelarije centralnog registra u AZKI-u, Kancelarija podregistra klasifikovanih informacija NATO-a i EU-a i kontrolnih tačaka koje se uspostavljaju u ministarstvima i državnim institucijama.</p> <p>2. Klasifikovane informacije NATO-a i EU-a se razmenjuju i upravljaju samo preko ovog Sistema.</p> <p>3. Sistem Registra klasifikovanih informacija NATO-a i EU-a je odgovoran za registraciju, širenje i upravljanje klasifikovanim informacijama razmenjenih u okviru saradnje NATO-a i EU-a.</p> <p>4. Državne institucije su obavezne da štite klasifikovane informacije NATO-a i EU-a u skladu sa standardima koji obezbeđuju isti stepen zaštite sa onim koji se zahteva od strane NATO-a i EU-a.</p> <p>5. Kancelarija centralnog registra klasifikovanih informacija NATO-a i EU-a u AZKI-u je odgovorna struktura za vođenje razmene, nadzora i kontrolu nad aspektima bezbednosti klasifikovanih informacija NATO-a i EU-a unutar sistema Registra.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 50 Informacioni i Paklasifikuar i NATO-s, BE-s, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare</p> <p>Informacioni i Paklasifikuar, i NATO-s BE-s, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare është informacioni i cili nuk përmban asnjë prej niveleve të klasifikimit, por që përdoret vetëm për arsye zyrtare nga institucionet shtetërore dhe nuk është i hapur për publikun.</p> | <p style="text-align: center;">Article 50 Unclassified information of NATO, the EU, other states and international organizations</p> <p>Unclassified information of NATO, the EU, other states and international organizations shall be the information that does not contain any of the classification levels but is used only for official reasons by state institutions and is accessible to the public.</p> | <p style="text-align: center;">Član 50 Neklasifikovane informacije NATO-a, EU-a, država i drugih međunarodnih organizacija</p> <p>Neklasifikovane informacije NATO-a, EU-a, država i drugih međunarodnih organizacija predstavljaju informacije koje nisu kategorizovane ni u jednom stepenu klasifikovanih informacija, ali se koriste isključivo iz službenih razloga od strane državnih institucija i nisu otvorene za javnost.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 51 Zbatimi i standardeve të BE-së dhe NATO-s</p> <p>1. AMIK është Autoritet i Sigurisë së Republikën së Kosovës që kujdeset për arritjen e standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në përputhje me kërkesat që derivojnë nga direktivat e sigurisë së NATO-s dhe BE-së.</p> <p>2. Agjencia shkëmben informacione të klasifikuara me të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe BE-së si dhe shteteve të tjera sipas marrëveshjeve të nënshkruara dhe legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>3. Sipas direktivave të NATO-s dhe BE-së, Agjencia njihet certifikatat e sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë industriale të shteteve me të cilat ka nënshkruar marrëveshje të sigurisë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 51 Implementation of EU and NATO standards</p> <p>1. APCI shall conduct inspections related to the implementation of security measures for the protection of classified information to public institutions and economic operators that have classified information.</p> <p>2. The Agency shall exchange classified information with all NATO and EU member states as well as with other States under the agreements signed and the relevant legislation in force.</p> <p>3. Under the NATO and EU directives, the Agency recognizes the security certificates of the personnel and industrial security certificates of the States with which it has signed security arrangements.</p> | <p style="text-align: center;">Član 51 Implementacija standarda EU i NATO-a</p> <p>1. AMIK je organ bezbednosti Republike Kosovo koji se stara o postizanju bezbednosnih standarda za zaštitu tajnih podataka u skladu sa zahtevima koji proizilaze iz bezbednosnih direktiva NATO-a i EU.</p> <p>2. Agencija će razmjenjivati tajne podatke sa svim državama članicama NATO-a i EU, kao i sa drugim državama u skladu sa potpisanim sporazumima i relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p>3. Prema direktivama NATO-a i EU, Agencija priznaje bezbednosne sertifikate osoblja i sertifikate o industrijskoj bezbednosti država sa kojima je potpisala sporazume o bezbednosti.</p> |

| <p align="center">Neni 52 Shkeljet e sigurisë dhe komprometimi i informacionit të klasifikuar</p> | <p align="center">Article 52 Security breaches and compromise classified information</p> | <p align="center">Član 52 Kršenje bezbednosti i kompromitovanje poverljivih informacija</p> |
|---|--|--|
| <p>1. Shkelja e sigurisë ndodhë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi nga një person i cili vepron në kundërshtim me rregullat e sigurisë të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore.</p> <p>2. Komprometimi i informacionit të klasifikuar ndodh atëherë kur, si rezultat i shkeljes së sigurisë ka shkaktuar zbulim tërësor apo pjesor të informacionit tek një person i paautorizuar.</p> <p>3. Çdo shkelje apo dyshim për shkelje të sigurisë duhet të raportohet menjëherë tek autoriteti kompetent i sigurisë AMIK.</p> <p>4. Kur dihet apo kur ka arsye të mjaftueshme për të pohuar se informacioni i klasifikuar është kompromentuar apo humbur autoriteti i sigurisë duhet të merr masa në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore duke:</p> <p>4.1. Informuar autoritetin origjiner;</p> <p>4.2. Siguruar se rasti po hetohet nga një person neutral në lidhje me çështjen;</p> <p>4.3. Përcaktuar dëmin potencial që i shkaktohet interesave të Republikës së Kosovës apo shteteve dhe organizatave tjera;</p> | <p>1. A security breach occurs as a result of an act or omission by a person who acts in contravention of the security rules set forth in this Law and other bylaws.</p> <p>2. The disclosure of classified information occurs when, as a result of the breach of security, has caused a complete or partial disclosure of information to an unauthorized person.</p> <p>3. Any breach or suspicion of a breach of security shall be reported immediately to the AMIK Security Authority.</p> <p>4. When known or when there is sufficient reason to assert that classified information is compromised or lost the security authority shall take measures in accordance with the law and bylaws by:</p> <p>4.1. Inform the originating authority;</p> <p>4.2. Ensure that the case is being investigated by a neutral person regarding the matter;</p> <p>4.3. Determine the potential damage that is caused to the interests of the Republic of Kosovo or other states and organizations;</p> | <p>1. Kršenje bezbednosti nastaje kao rezultat dela ili propusta od strane osobe koja postupa suprotno bezbednosnim pravilima utvrđenim ovim zakonom i drugim podzakonskim aktima.</p> <p>2. Otkrivanje tajnih podataka nastaje kada je, kao rezultat kršenja sigurnosti, prouzrokovano potpuno ili djelimično otkrivanje informacija neovlaštenom licu.</p> <p>3. Svako kršenje ili sumnja da je došlo do kršenja bezbednosti odmah se prijavljuje organu bezbednosti AMIK-a.</p> <p>4. Kada je to poznato ili kada postoji dovoljan razlog da se tvrdi da su poverljive informacije ugrožene ili izgubljene, organ bezbednosti preuzima mere u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima tako što:</p> <p>4.1. Informiše nadležni organ;</p> <p>4.2. Obezbeđuje da slučaj bude istražen od strane neutralne osobe u vezi s tim pitanjem;</p> <p>4.3. Utvrđuje potencijalnu štetu koja je prouzrokovana interesima Republike Kosovo ili drugim državama i organizacijama;</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>4.4. Marr masat e përshtatshme për parandalimin e një përsëritje;</p> <p>4.5. Të njoftojë autoritetet përkatëse për veprimin e kryer.</p> <p>5. Çdo person përgjegjës për shkelje e rregullave të sigurisë të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore do t'i nënshtrohet ndëshkimeve disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Çdo person përgjegjës për kompromentim apo humbje të informacionit të klasifikuar do t'i nënshtrohet ndëshkimeve disiplinore/apo veprimeve ligjore në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikuara.</p> | <p>4.4. Take appropriate measures to prevent a repetition;</p> <p>4.5. Notify the relevant authorities of the action taken.</p> <p>5. Any person responsible for violation of the security rules set forth in this Law and by-laws shall be liable to disciplinary penalties in accordance with the legislation in force.</p> <p>6. Any person liable for compromise or loss of classified information shall be liable to disciplinary action or legal action in accordance with the applicable laws and by-laws.</p> | <p>4.4. Poduzimai odgovarajuće mjere kako bi se sprečilo ponavljanje;</p> <p>4.5. Obaveštave nadležne organe o preduzetim merama.</p> <p>5. Svaka osoba koja je odgovorna za kršenje sigurnosnih pravila utvrđenih ovim zakonom i podzakonskim aktima podleže disciplinskoj kazni u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Svako lice odgovorno za kompromitovanje ili gubitak poverljivih informacija podleže disciplinskom postupku ili sudskom postupku u skladu sa važećim zakonima i podzakonskim aktima.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 53 Humbja e Informacioneve të Klasifikuara</p> <p>1. Për çfarëdo humbje të dyshuar, shkelje të dyshuar të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, si dhe për çfarëdo qasje të dyshuar të paautorizuar në informacione të klasifikuara, të gjithë bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara menjëherë i raportojnë për këtë institucionit të tyre përkatës publik, prokurorisë së shtetit si dhe Agjencisë.</p> <p>2. Agjencia me iniciativën e vet ose me kërkesë të autoritetit përkatës në rastet e shkeljeve të dyshuara me këtë ligj, menjëherë i merr të gjitha masat e nevojshme për të:</p> | <p style="text-align: center;">Article 53 Loss of Classified Information</p> <p>1. For any suspected loss, alleged breach of classified information security, and any unauthorized unauthorized access to Classified Information, all Authorized Classified Information Holders shall immediately report to their respective institution public, state prosecution and the Agency.</p> <p>2. The Agency, upon its own initiative or at the request of the appropriate authority in cases of alleged violations with this Law, shall immediately take all necessary measures to:</p> | <p style="text-align: center;">Član 53 Gubitak klasifikovanih informacija</p> <p>1. Za svaki sumnjiv gubitak, navodno kršenje bezbednosti poverljivih informacija i svaki sumnjivi neovlašćeni pristup klasifikovanim informacijama, svi ovlašćeni nosioci tajnih podataka odmah će to prijaviti svojoj relevantnoj javnoj instituciji, državnom tužilaštvu i Agenciji.</p> <p>2. Agencija, na sopstvenu inicijativu ili na zahtev nadležnog organa u slučajevima navodnih kršenja ovog zakona, odmah će preduzeti sve neophodne mere da:</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>2.1. Njoftuar prokurorin e shtetit në rast se shkelja e supozuar dyshohet se përbën vepër penale;</p> <p>2.2. inspektuar rastin;</p> <p>2.3 identifikuar shkakun e humbjes,</p> <p>2.4. gjurmuar ndonjë hapje nga persona të paautorizuar për t'u qasur në informacione të tilla;</p> <p>2.5. larguar ndonjë efekt të dëmshëm dhe për të parandaluar humbje të mëtejme të informacioneve të klasifikuara;</p> <p>3. Në rast se shkelja e supozuar dyshohet se përbën vepër penale, e njofton prokurorin e shtetit.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI VII DISPOZITAT NDËSHKUESE</p> <p style="text-align: center;">Neni 54 Sanksionet Penale</p> <p>1. Kushdo që zbulon ose nuk ruan informacionin e klasifikuar si “KONFIDENCIAL”, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite.</p> | <p>2.1. Notifying the state prosecutor in case the alleged violation is suspected of constituting a criminal offense;</p> <p>2.2. Inspecting the case;</p> <p>2.3 identifying the cause of loss,</p> <p>2.4 track down any opening by unauthorized persons to access such information;</p> <p>2.5 removing any harmful effect and prevent further loss of classified information;</p> <p>3. In case if the alleged violation is suspected of constituting a criminal offense, it shall notify the state prosecutor.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER VII PUNISHMENT PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 54 Criminal sanctions</p> <p>1. Anyone who discloses or does not store classified information as a "CONFIDENTIAL" commits a criminal offense and is sentenced to imprisonment of one (1) to five (5) years.</p> | <p>2.1. Obavesti državnog tužioca u slučaju da se sumnja da navodno kršenje čini krivično delo;</p> <p>2.2. Pregledati slučaj;</p> <p>2.3. identifikovati uzrok gubitka,</p> <p>2.4. pronalaženje bilo kakvog otvaranja od strane neovlašćenih lica za pristup takvim informacijama;</p> <p>2.5. Uklanjanje štetnih efekata i sprečavanje daljeg gubitka klasifikovanih informacija;</p> <p>3. Ukoliko se sumnja da navodna povreda činiza krivično delo, obavestiće državnog tužioca.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE VII KAZNE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 54. Krivične sankcije</p> <p>1. Ko otkrije ili ne sačuva poverljive informacije klasifikovane kao "POVJERLJIVO", čini krivično djelo i kažnjava se kaznom zatvora u trajanju od jedne (1) do pet (5) godina.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>2. Kushdo që zbulon ose nuk ruan informacionin e klasifikuar si “SEKRET”, kryen veprë penale dhe dënohet me burgim prej tri (3) deri dhjetë (10) vite.</p> <p>3. Kushdo që zbulon ose nuk ruan informacionin e klasifikuar si “TEPËR SEKRET”, kryen veprë penale dhe dënohet me burgim prej pesë (5) deri dymbëdhjetë (12) vite.</p> | <p>2. Whoever discloses or retains classified information as "SECRET" commits a criminal offense and is sentenced to imprisonment of three (3) to ten (10) years.</p> <p>3. Whoever discloses or retains classified information as "TOP SECRET" commits a criminal offense and is sentenced to imprisonment of five (5) to twelve (12) years.</p> | <p>2. Ko otkrije ili ne sačuva poverljive informacije klasifikovane kao "TAJNO", čini krivično djelo i kažnjava se kaznom zatvora u trajanju od tri (3) do deset (10) godina.</p> <p>3. Ko otkrije ili ne sačuva poverljive informacije klasifikovane kao "VEOMA TAJNO", čini krivično delo i biv akažnjen zatvorom u trajanju od pet (5) do dvanaest (12) godina.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 55 Inspektimi i institucionve publike dhe operatorëve ekonomik</p> <p>1. AMIK zhvillon inspektive lidhur me zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara tek institucionet publike dhe operatorët ekonomik që kanë në administrim informacionë të klasifikuara.</p> <p>2. Inspektimi zhvillohet mbi baza të rregullta kohore dhe me njoftim paraprak të institucionit publik.</p> <p>3. Objekt i inspektimit pa njoftim paraprak bëhen vetëm atë institucion apo operator ekonomik për të cilin ka informacione të besueshme se ka shkelje të sigurisë sa i përket administrimit të informacioneve të klasifikuara.</p> <p>4. Objekt i inspektimit janë disiplinat e mëposhtme:</p> | <p style="text-align: center;">Article 55 Inspection of Public Institutions and Economic Operators</p> <p>1. AMIK conducts inspections related to the implementation of security measures for the protection of classified information to public institutions and economic operators that have classified information.</p> <p>2. The Inspection takes place out on a regular basis and with prior notice of the public institution.</p> <p>3. The object of the inspection without prior notice shall be only those institutions or economic operators for which there is reliable information that there is security breach regarding the administration of classified information.</p> <p>4. Objects of inspection are the disciplines below;</p> | <p style="text-align: center;">Član 55 Inspekcija javnih institucija i ekonomskih operatera</p> <p>1. AZKI vrši inspekcije u vezi sa sprovođenjem mera bezbednosti za zaštitu klasifikovanih informacija kod javnih institucija i ekonomskih operatera koji upravljaju klasifikovanim informacijama.</p> <p>2. Inspekcija se vrši redovno i uz prethodno obaveštavanje javnih institucija.</p> <p>3. Predmet inspekcija bez prethodnog obaveštavanja su samo one institucije ili ekonomski operateri za koje postoje pouzdane informacija da ima kršenja bezbednosti u smislu upravljanja klasifikovanim informacijama.</p> <p>4. Predmet inspekcija su sledeće discipline:</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>4.1. Siguria e personelit;</p> <p>4.2. Siguria industriale;</p> <p>4.3. Siguria e e sistemeve te komunikimit dhe informacionit;</p> <p>4.4. Siguria fizike;</p> <p>4.5. Administrimi i informacioneve të klasifikuara.</p> <p>5. AMIK siguron standardet e sigurisë fizike për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që administron dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre sipas kërkesave të parapara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Pas përfundimit të inspektimit të masave të sigurisë, AMIK harton raport të hollësishëm lidhur me gjetjet, si dhe propozon marrjen e masave përkatëse për rritjen e shkallës së sigurisë së informacionit të klasifikuar.</p> <p>7. Raporti i drejtohet drejtuesit të institucionit publik përkatës.</p> <p>8. Në koordinim me drejtuesin e institucionit publik, hartohet plani për zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë nga raporti i inspektimit.</p> <p>9. AMIK mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve tek institucioni publik dhe nëse të njejtat nuk</p> | <p>4.1. Personnel security;</p> <p>4.2. Industrial security;</p> <p>4.3. Security of communication systems and information;</p> <p>4.4. Physical security;</p> <p>4.5. Administration of classified information.</p> <p>5. AMIK provides the physical security standards for the protection of classified information that administers and monitors their implementation according to the requirements set out in the applicable legislation.</p> <p>6. Upon completion of the inspection of the security measures, the AMIK compiles a detailed report on the findings and proposes to take appropriate measures to increase the degree of security of calcium informacon.</p> <p>7. The report is addressed to the head of the relevant public institution.</p> <p>8. In coordination with the head of the public institution, the plan for the implementation of the recommendations resulting from the inspection report is drafted.</p> <p>9. AMIK supervises the implementation of the recommendations to the public institution and if the</p> | <p>4.1. Bezbednost osoblja;</p> <p>4.2. Industrijska bezbednost;</p> <p>4.3. Bezbednost komunikacionih i informacionih sistema;</p> <p>4.4. Fizička bezbednost;</p> <p>4.5. Upravljanje klasifikovanim informacijama.</p> <p>5. AZKI obezbeđuje standarde fizičke bezbednosti za zaštitu klasifikovanih informacija koje upravljaju i nadgledaju njihovu primenu u skladu sa zahtevima utvrđenim važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Po završetku inspekcije mera bezbednosti, AZKI izrađuje detaljan izveštaj o nalazima i predlaže preduzimanje odgovarajućih mera za povećanje stepena bezbednosti klasifikovanih informacija.</p> <p>7. Izveštaj se upućuje rukovodiocu odgovarajuće javne institucije.</p> <p>8. U koordinaciji sa rukovodiocem javne institucije izrađuje se plan za sprovođenje preporuka koje proizilaze iz izveštaja o inspekciji.</p> <p>9. AZKI nadgleda sprovođenje preporuka kod javnih institucija i ako se iste ne sprovede u</p> |
|---|---|--|

zbatohen brenda afateve të parapara paraprakisht, njofton me shkrim mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të drejtuesit të institucionit përkatës, i cili ishte objekt i inspektimit.

**KAPITULLI VIII
AGJENCIA PËR MBROJTJEN E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
(AMIK)**

**Neni 56
Themelimi dhe statusi i AMIK**

1. Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK) themelohet si Agjenci e sigurisë kombëtare në fushën e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe kontraktuesve të tyre që në çfarëdo forme mund të kenë në administrim informacionet e klasifikuara.

2. Të gjithë të punësuarit dhe personeli i angazhuar në AMIK duhet të jenë politikisht të paanshëm, profesional, pa paragjykime në gjykimin e tyre dhe të veprojnë vetëm në pajtim me ligjin.

same are not implemented within the foreseen deadlines, it notifies in writing the direct supervision of the relevant institution of the respective institution which was the inspection facilities.

**CHAPTER VIII
AGENCY FOR PROTECTION OF
CLASSIFIED INFORMATION (APCI)**

**Article 56
The establishment and status of the APCI**

1. Agency for Protection of Classified Information (APCI) shall be established as a national security agency in the field of protection of classified information for all public institutions of the Republic of Kosovo and their contractors who in any form may have classified information under administration.

2. The Agency for Protection of Classified Information and all employees and personnel engaged therein shall be politically impartial, professional, without prejudices in their judgments, and act only in accordance with the law and shall not take instructions from any person or institution.

okviru unapred predviđenih rokova, pismenim putem obaveštava direktnog nadzornika rukovodioca odgovarajuće institucije koja je bila predmet inspekcije.

**POGLAVLJE VIII
AGENCIJA ZA ZAŠTITU
KLASIFIKOVANIH INFORMACIJA
(AZKI)**

**Član 56
Osnivanje i status AZKI**

1. Agencija za zaštitu klasifikovanih informacija (AZKI) se osniva kao agencija za nacionalnu bezbednost u oblasti zaštite klasifikovanih informacija za sve javne institucije Republike Kosovo i njihovih izvođača radova koji u bilo kom obliku mogu upravljati klasifikovanim informacijama.

2. Agencija za zaštitu klasifikovanih informacija, kao i svi zaposleni i osoblje angazovano za rad u agenciji, moraju da budu politički nepristrasni, profesionalni, bez predrasuda u svojoj proceni i da deluju isključivo u skladu sa zakonom i da ne primaju uputstva od bilo koje osobe ili institucije.

| | | |
|---|---|---|
| <p>3. AMIK është person juridik dhe ka selinë në Prishtinë.</p> <p>4. AMIK ka logon e saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Përgjegjësitë e AMIK në fushën e Mbrojtjes së Informacionit të Klasifikuar</p> <p>1. AMIK-u është institucion qendror i specializuar në fushën e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar me mandat për të organizuar, drejtuar e kontrolluar masat për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar dhe verifikimin e sigurisë për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës si dhe kontraktueseve të tyre, që ka përgjegjësi për:</p> <p>1.1. hartimit të politikave;</p> <p>1.2. ndjekjes së procedurave;</p> <p>1.3. mbikëqyrjes së institucioneve dhe kontraktuesve në kontratat e klasifikuara;</p> <p>1.4. edukimit të sigurisë;</p> <p>1.5. sigurisë së personelit;</p> <p>1.6. sigurisë fizik;</p> | <p>3. AMIK is a legal person and has its headquarters in Prishtina.</p> <p>4. AMIK has its own logo.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Responsibilities of AMIK in the field of Classified Information Protection</p> <p>1. AMIK is a central institution specializing in the field of classified information classified with the mandate to organize, direct and control measures for storing, classifying and administering classified information and verifying security for all institutions of the Republic of Kosovo as well as their contractors, who are responsible for:</p> <p>1.1. policy drafting;</p> <p>1.2. follow up of procedures;</p> <p>1.3. surveillance of institutions and contractors in classified contracts;</p> <p>1.4. security education;</p> <p>1.5. security of personnel;</p> <p>1.6. Physical security;</p> | <p>3. AZKI je pravno lice sa sedištem u Prištini.</p> <p>4. AZKI ima svoj logo.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Odgovornosti AZKI-a u oblasti zaštite klasifikovanih informacija</p> <p>1. AZKI je nezavisna centralna specijalizovana institucija u oblasti zaštite klasifikovanih informacija sa mandatom za organizovanje, vođenje i kontrolisanje mera za čuvanje, klasifikaciju i upravljanje klasifikovanim informacijama i bezbednosnu proveru za sve institucije RKS-a kao i njihovih izvođača radova, i odgovorna je za:</p> <p>1.1. izradu politika;</p> <p>1.2. praćenje procedura ;</p> <p>1.3. nadgledanje institucija i izvođača radova u klasifikovanim ugovorima;</p> <p>1.4. bezbednosnu edukaciju;</p> <p>1.5. bezbednost osoblja;</p> <p>1.6. fizičku bezbednost;</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>1.7. sigurisë së informacionit;</p> <p>1.8. sigurisë industriale;</p> <p>1.9. sigurimin e sistemeve të komunikimit dhe informacionit;</p> <p>1.10. zhvillimit të negociatave për lidhjen e marrëveshjeve të sigurisë me shtete përkatëse;</p> <p>1.11. mbikëqyrë zbatimin e traktateve apo instrumenteve ndërkombëtare mbi mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe propozon marrjen e masave lidhur me këtë.</p> <p>2. AMIK është autoritet kompetent i sigurisë për Republikën e Kosovës, lidhur me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare.</p> <p>3. AMIK bashkëpunon me institucionet publike, operatorët ekonomik të interesuar dhe autoritetet homologe të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për kryerjen e detyrave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>4. Plani strategjik i punës të AMIK përmban objektivat e përgjithshme dhe specifike për arritjen e standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, i propozohet Kryeministrit për miratim.</p> | <p>1.7. information security;</p> <p>1.8. industrial security;</p> <p>1.9. providing communication and information systems;</p> <p>1.10. negotiation development of the conclusion of security agreements with respective states;</p> <p>1.11. Supervise the implementation of treaties or international instruments on the protection of classified information and proposes to take appropriate measures.</p> <p>2. AMIK is the competent security authority for the Republic of Kosovo regarding the the protection of classified information of foreign states and international organizations.</p> <p>3. AMIK cooperates with public institutions, economic operators concerned and counterpart authorities of states and international organizations for the performance of the tasks provided for by the legislation in force.</p> <p>4. The AMIK's strategic plan contains the general and specific objectives for achieving security standards for the protection of classified information, proposed to the Prime Minister for approval.</p> | <p>1.7. bezbednost informacija;</p> <p>1.8. industrijsku bezbednost;</p> <p>1.9. bezbednost komunikacionih i informacionih sistema;</p> <p>1.10. vođenje pregovora za zaključivanje bezbednosnih sporazuma sa odgovarajućim državama;</p> <p>1.11. adgledanje sprovođenja međunarodnih ugovora ili instrumenata o zaštiti klasifikovanih informacija i predlaže preduzimanje mera u vezi s tim.</p> <p>2. AZKI je nadležni bezbednosni organ za Republiku Kosovo u vezi sa zaštitom klasifikovanih informacija stranih država i međunarodnih organizacija</p> <p>3. AZKI saraduje sa javnim institucijama, zainteresovanim ekonomskim operaterima i srodnim organima država i međunarodnih organizacija za obavljanje zadataka predviđenih važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Strateški plan rada AZKI-a sadrži opšte i specifične ciljeve za postizanje bezbednosnih standarda za zaštitu klasifikovanih informacija, predlaže se Premijeru na usvajanje.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|--|---|
